MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT




# BULETINI STATISTIKOR VJETOR

# '2017

Tiranë, Qershor 2018

Përgatitur nga:
**DREJTORIA E INFORMACIONIT TË TREGUT TË PUNËS DHE E INFORMATIZIMIT**

© Copyringht, SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT, '2018

Përdorimi pjesor ose i plotë i të dhënave të këtij botimi,
lejohet vetëm me kushtin e citimit të plotë të burimit të informacionit.

# PERMBAJTJA

PERMBAJTJA ... 3
Shkurtimet e përdorura: ... 3
Lista e tabelave ... 4
Lista e figurave ... 5
PARATHËNIE ... 7
Metodologjia dhe definicionet ... 8
HYRJE ... 10
TE DHENAT KRYESORE TE TREGUT TE PUNES ... 10
KAPITULLI I ... 12
TË DHËNA PËR PUNËKËRKUESIT E REGJISTRUAR ... 12
I.1 Ndryshimi vjetor i regjistrit të punëkërkuesit ... 13
I.2 Karakteristikat Individuale të Pu.Pa. ... 15
A. GRUPMOSHA ... 15
B. NIVELI ARSIMOR ... 16
C. GJINIA ... 17
I.3 GRUPET E VECANTA TE PU.PA. ... 18
a. PU.PA AFATGJATË ... 19
b. PU.PA ROME/EGJIPTIANE ... 20
c. PU.PA ME AFTËSI TE KUFIZUAR (PAK) ... 22
d. PU.PA EMIGRANTE TE KTHYER ... 23
I.4 Kategoritë Profesionale të PU.PA-ve ... 25
KAPITULLI II ... 29
TË DHËNA PER OFERTËN PËR PUNË ... 29
II.1 KARAKTERISTIKAT E PERGJITHSHEM TE BIZNESIT ... 30
II.2 VENDET E LIRA TË REGJISTRUARA NË ZYRAT E PUNËSIMIT ... 34
II.3 LEJET E PUNES DHE VËRTETIMET E PUNËSIMIT PËR TË HUAJT ... 38
KAPITULLI III ... 43
TE DHËNA PER SHËRBIMET DHE PROGRAMET ... 43
Treguesit e monitorueshëm për '2016 ... 43
III.1 PUNKËRKUESIT E PAPUNË TË PUNËSUAR ... 44
a. GJINIA ... 46
b. GRUPMOSHA ... 47
c. NIVELI ARSIMOR ... 48
d. GRUPET E VEÇANTA ... 50
III.2 TË DHËNA PËR PJESMARRËSIT NË PROGRAMET E NXITJES SË PUNËSIMIT ... 53
a. SUBJEKTET PËRFITUESE ... 55
b. PU.PA - PËRFITUES ... 56
III.3 TË DHËNA PËR PJESMARRËSIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT PROFESIONAL ... 58
a. Ofruesit publik te formimit profesional ... 58
b. Struktura e Kursantëve ... 59
III.4. TE DHËNA PËR PJESËMARRËSIT NË PROGRAMIN E PAGESËS SË PAPUNËSISË ... 66
KAPITULLI IV ... 70
TE DHENA PER ADMINISTRIMIN E BURIMEVE FINANCIARE DHE NJEREZORE ... 70

## SHKURTIMET E PËRDORURA:

**MFE** -Ministria e Financave dhe Ekonomisë

**ShKP** -Shërbimi Kombëtar i Punësimit

**DRFPP** - Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik

**PU.PA** -Punëkërkues të Papunë.

## LISTA E TABELAVE

Tab.1 Treguesit kryesorë tëTregut të punës ... 10
Tab.2 Treguesit kryesorë të tregut të punës për popullsinë (15-64) vjeç, sipas Qarqeve ... 11
Tab.3 Bilanci vjetor i papunësisë së regjistruar sipas Qarqeve ... 14
Tab.4 Struktura moshore e PU.PA sipas Qarqeve (%) ... 15
Tab.5 Struktura arsimore e PU.PA sipas Qarqeve ... 16
Tab.6 PU.PA Femra sipas Karakteristikave individuale ... 18
Tab.7 PU.PA afatgjatë sipas karakteristikave individuale ... 19
Tab.8 PU.PA Romë sipas Qarqeve ... 21
Tab.9 PU.PA Egjiptianë sipas Qarqeve ... 22
Tab.10 PU.PA emigrantë, të kthyer sipas Qarqeve ... 24
Tab.11 PU.PA sipas kategorive profesionale ... 26
Tab.12 Të dhëna për subjektet dhe të punësuarit ... 30
Tab.13 Të dhëna për subjektet sipas Rajoneve ... 30
Tab.14 Subjektet private të regjistruara në ZP, sipas Madhësisë dhe Aktivitetit ekonomik ... 32
Tab.15 Kontaktet me punëdhënësit sipas mënyrës së kontaktimit ... 34
Tab.16 Lejet e punës për te huajt sipas Qarqeve dhe Tipit të lejes ... 39
Tab.18 Treguesit kryesorë të monitorimit dhe realizimi i tyre sipas Qarqeve ... 43
Tab.19 Niveli i plotësimit të ofertave sipas Qarqeve ... 44
Tab.20 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) sipas Grupmoshave dhe Qarqeve ... 48
Tab.21 PU.PA të punësuar sipas Qarqeve dhe Nivelit arsimor ... 49
Tab.22 PU.PA të punësuar (Ndërmjetësim+gjeti punë vetë) sipas Gjinisë dhe Grupeve të veçanta ... 51
Tab.23 Pu.PA të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) sipas Grupeve të veçanta dhe Qarqeve ... 52
Tab.24 Të dhëna për programet e nxitjes së punësimit të zbatuara gjatë '2017. ... 54
Tab.25 Subjektet dhe PU.PA- të përfitues nga Programet e nxitjes se punësimit sipas Qarqeve ... 54
Tab.26 Të dhëna për Programet e nxitjes se punësimit sipas Qarqeve. ... 57
Tab.27 PU.PA përfitues nga Programet e nxitjes së punësimit sipas Grupeve të veçanta ... 57
Tab.28 Struktura e kursantëve që përftuan pa pagesë kurse pranë Qendrave Publike të FP ... 59
Tab.29 Struktura e kursantëve që përftuan me pagesë kurse pranë Qendrave Publike të FP ... 59
Tab.30 Të dhëna për kurset e formimit profesional të përfunduara në QFP Publike ... 60
Tab.31Të dhëna për PU.PA të trajnuar sipas QFP Publike ... 61
Tab.32 Të dhëna për pjesëmarrësit në Kurset e Formimit Profesional sipas profesioneve (Qendrat Publike) ... 62
Tab.33 Bilanci vjetor i skemës së pagesës së papunësisë. ... 68
Tab.34 Pu.Pa të regjistruar në pagesë papunësie sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor ... 69
Tab.35 Fondi i SHKP-së sipas programeve në Vite ... 70
Tab.36 Realizimi i Treguesve të Buxhetit për vitin 2017 ... 72
Tab.37 Stafi i SHKP sipas Kategorisë profesionale ... 73

## LISTA E FIGURAVE

Fig.1 Shkalla e rritjes së punësimit sipas Aktivitetit ekonomik, Tr. 4 2017/ Tr.4 2016 .... 11
Fig.2 Dinamika e uljes së Numrit të PU.PA sipas Muajve .... 13
Fig.3 Numri i PU.PA sipas Grupeve të papunësisë.... 13
Fig.4 Numri i PU.PA të çrregjistruar sipas arsyeve .... 14
Fig.5 Numri i PU.PA.,të regjistruar sipas Grupmoshave 2016/2017.... 15
Fig.6 Numri i PU.PA, të regjistruar sipas Nivelit arsimor 2016/2017 .... 16
Fig.7 Punëkërkues të papunë sipas Gjinisë dhe Qarqeve .... 17
Fig.8 PU.PA Femra kryefamiljarë sipas Grupeve të papunësisë .... 17
Fig.9 PU.PA afatgjatë sipas periudhës së Afatgjatësisë në papunësi.... 19
Fig.10 PU.PA të regjistruar afatgjatë sipas Periudhës së afatgjatësisë dhe Qarqeve.... 20
Fig.11 PU.PA të regjistruar Romë sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor.... 20
Fig.12 PU.PA të regjistruar Egjiptianë sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor .... 21
Fig.13 PU.PA PAK të regjistruar sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor.... 22
Fig.14 PU.PA me aftësi të kufizuar, sipas Qarqeve .... 23
Fig.15 PU.PA Emigrantë sipas karakteristikave të kthimit.... 23
Fig.16 PU.PA emigrantë të kthyer sipas karakteristikave individuale.... 24
Fig.17 PU.PA emigrantë, të kthyer sipas mbështetjes së kërkuar për ri integrim.... 25
Fig.18 PU.PA sipas kategorive kryesore profesionale .... 26
Fig.19 PU.PA të regjistruar sipas Profesioneve dhe Qarqeve.... 28
Fig.20 Punësimi sipas Pronësisë së subjektit .... 30
Fig.21 Subjektet e regjistruara në ZP, sipas aktiviteteve ekonomike .... 31
Fig.22 Subjektet e regjistruara në ZP me Pronësi të përbashkët apo të huaj, sipas Qarqeve .... 33
Fig.23 Subjektet e regjistruara në ZP me Pronësi të përbashkët apo të huaj, sipas Madhësisë.... 33
Fig.24 Numri i kontakteve me punëdhënësin si dhe vendet e lira të marra sipas Qarqeve.... 35
Fig.25 Vendet e reja te punës të shpallura, sipas aktiviteteve ekonomike .... 35
Fig.26 Vendet e reja të punës sipas Qarqeve .... 36
Fig.27 Vendet e reja të punës sipas Kategorive Profesionale.... 36
Fig.28 Vendet e lira të regjistruara në ZP sipas Aktivitete ekonomike .... 37
Fig.29 Vendet e lira te punës krahasuar me Numrin e PU.PA sipas Qarqeve .... 37
Fig.30 Vendet e lira te punës krahasuar me numrin e PU.PA sipas Kategorive profesionale.... 38
Fig.31 Numri i të huajve të punësuar në Shqipëri sipas Qarqeve .... 39
Fig.32 Numri i të huajve të punësuar në Shqipëri sipas Statusit në punësim.... 39
Fig.33 Shpërndarja e Lejeve të punës për të huajt, sipas Aktiviteteve ekonomike.... 40
Fig.34 Numri i punonjësve të huaj sipas Shtetësisë.... 41
Tab.17 Vërtetimet e punësimit sipas shtetësisë. Lejet e punës sipas shtetësisë.... 41
Fig.35 Pu.Pa. të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) 2016/2017 sipas Qarqeve .... 45

Fig.36 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) / PU.PA te regjistruar sipas Qarqeve ........ 45
Fig.37 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) sipas Gjinisë dhe statusit familjar...... 46
Fig.38 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) sipas Gjinisë dhe Qarqeve ................ 46
Fig.39 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) sipas Grupmoshave ........................ 47
Fig.40 Pu.Pa., të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) /PU.PA të regjistruar sipas Grupmoshave........ 47
Fig.41 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) sipas Nivelit arsimor.......................... 49
Fig.42 PU.PA. të punësuar/PU.PA.të regjistruar sipas Nivelit arsimor...................................................... 49
Fig.43 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) 2016/2017 sipas Nivelit arsimor........ 50
Fig.44PU.PA të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) /PU.PA të regjistruar sipas Grupeve të veçanta........ 51
Fig.45 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) nga Grupet e veçanta 2016/2017.... 52
Fig.46 Dinamika e rritjes së Fondit të Nxitjes së punësimit sipas Viteve.................................................. 54
Fig.47 Subjektet përfituese sipas Aktiviteteve ekonomike......................................................................... 55
Fig.48 Subjektet përfituese sipas VKM dhe Aktiviteteve ekonomike......................................................... 55
Fig.49 PU.PA përfitues sipas VKM............................................................................................................ 56
Fig.50 PU.PA përfitues sipas Grupmoshës. Fig.51 PU.PA përfitues sipas Nivelit arsimor............. 56
Fig.52 Numri i kursantëve sipas QFP Publike ........................................................................................... 58
Fig.53 Të trajnuarit në QFP Publike sipas Profesioneve............................................................................ 60
Fig.54 Të dhëna për PU.PAtë trajnuar sipas profesioneve (Qendrat Publike) .......................................... 63
Fig.55 Të dhëna për PU.PA e trajnuar nga Grupet e veçanta.................................................................... 64
Fig.56 Të trajnuar sipas Grupmoshave dhe Profesioneve ......................................................................... 64
Fig.57 Pjesëmarrësit sipas Nivelit arsimor dhe Profesioneve .................................................................. 65
Fig.58 Niveli i Punësimit pos Formim sipas Kurseve................................................................................. 65
Fig.59 Fondi i Pagesës së papunësisë në Vite .......................................................................................... 67
Fig.60PU.PA të regjistruar në Pagesë papunësie sipas Muajve .............................................................. 67
Fig.61 PU.PA të regjistruar në pagesë papunësie sipas Periudhes së përfitimit....................................... 68
Fig.62 Hyrjet sipas sektorëve dhe Qarqeve ............................................................................................... 68
Fig.63 PU.PA të regjistruar në pagesë papunësie sipas Qarqeve dhe Gjinisë ......................................... 69
Fig.64 Shpërndarja gjeografike e Institucioneve të Punësimit.................................................................... 71
Fig.65 Stafi i SHKP-së sipas Gjinisë .......................................................................................................... 73
Fig.66 Shpërndarja e personelit të ZP sipas Qarqeve................................................................................ 74

## PARATHËNIE

SHËRBIMI KOMBËTAR I PUNËSIMIT, prezanton për vendimmarrësit, administratorët, komunitetin e biznesit, studiuesit dhe të gjithë përdoruesit e statistikave, publikimin "Buletini Statistikor '2017", i cili përmban të dhëna të detajuara për Tregun e punës për vitin 2017.

Statistikat e tregut të punës që siguron dhe publikon Shërbimi Kombëtar i Punësimit, japin një përshkrim të strukturës së tregut të punës bazuar në informacionin periodike të të dhënave administrative si dhe rezultatet kryesore të politikave shtetërore të punësimit si rregullatorë në këtë treg.

Qëllimi kryesor i prodhimit të statistikave të tregut të punës është marrja e një informacioni sa më të plotë mbi këtë treg dhe dinamikën e tij, si dhe për të vënë në dispozicion të politikëbërësve statistikat e duhura për hartimin e politikave të punësimit.

Të dhënat për punësimin dhe papunësinë që publikohen nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit (ShKP), bazohen në burimet administrative dhe i referohen:

a. Të punësuarve të regjistruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
b. Punëkërkuesve të papunë të regjistruar në Zyrat e Punësimit;
c. Punëkërkuesve të papunë të regjistruar që përfshihen në politikat aktive të tregut të punës.

Seria kohore e të dhënave administrative të publikuara nga ShKP, nis nga '1998, vit i krijimit të tij dhe ato janë përgatitur dhe publikuar me periodicitet 3 mujor dhe vjetor.

Një tjetër burim referues i te dhënave që publikon ShKP është Anketa e Forcave të Punës e kryer nga INSTAT. Anketa e Forcave të Punës (AFP) që është një vrojtim statistikor që kryhet pranë familjeve, siguron informacion gjithëpërfshirës mbi situatën e tregut të punës. Objektivi kryesor për kryerjen e AFP është ngritja e një sistemi statistikor të qëndrueshëm të statistikave të forcave të punës sipas standardeve të EUROSTAT me qëllim mundësimin e:

a. Vlerësimit sasior dhe dinamik të zhvillimeve të tregut të punës;
b. Përmirësimit të statistikave mbi punësimin dhe papunësinë;
c. Përmirësimit të vlerësimit të punësimit informal si pjesë e ekonomisë së pavrojtuar.

AFP u krye për herë të parë në vitin 2007 me periodicitet vjetor. Nga tremujori i parë 2013 e në vazhdim, INSTAT publikon tregues mbi tregun e punës të vlerësuar bazuar në të dhënat e anketës së forcave të punës me frekuencë tremujore.

## METODOLOGJIA DHE DEFINICIONET

**Popullsia në moshë pune** - konsiderohen personat e popullsisë (15-64) vjeç.Të dhënat mbi këtë kategori sigurohen nëpërmjet Censusit të Popullsisë të realizuar nga INSTAT.

Gjatë muajit Tetor 2011, INSTAT-irealizoi Censusin e popullsisë dhe banesave në Republikën e Shqipërisë, duke patur si koncept bazë "momentin e censusit" që përkon mesnatën e 30 Shtator dhe 1 Tetor 2011.

**Forca e punës** - nënkupton popullsinë ekonomikisht aktive dhe që përcaktohet si shumatore e numrit të personave të punësuar me numrin e personave të papunë. Të dhënat mbi forcën e punës deri në vitin 2007 ishin vetëm të dhëna administrative, ndërsa pas këtij viti ato sigurohen nga AFP.

**Të punësuar** - konsiderohen personat që kanë kryer një punë, (qoftë dhe për 1 orë) kundrejt një page, ose përfitimi, gjatë periudhës së referencës. Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës si dhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për:

1. Leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi të përkohshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trajnim të lidhur direkt me punën aktuale;
2. Të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet për të cilët (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal ose (b) personi merr 50% ose më shumë të pagës;
3. Të vetëpunësuar që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale;
4. Punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat që punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetëkonsum, janë konsideruar të punësuar. Ndërsa në të dhënat administrative "të punësuar", janë konsideruar të gjithë personat të cilët ndërmarrjet i deklarojnë si të tillë në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

**P**ërcaktimi i të dhënave të punësimit **në** Shqipëri, bëhet nëpërmjet AFP dhe Burimeve Administrative.

**Të papunë** - konsiderohen personat që në javën e referencës plotësojnë këto kushte[1]:

- ✓ Nuk kanë punuar (as nuk kishin një punë nga e cila munguan përkohësisht);
- ✓ Ishin të gatshëm për të punuar nëse do të gjenin një punë brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës;

[1] Sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Punës (ILO) dhe të EUROSTAT-it.

- ✓ Kanë kërkuar punë në mënyrë aktive gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës.

Burimet e informacionit për papunësinë në Shqipëri janë AFP dhe Burimet Administrative (ku papunësisë i referohemi si papunësi e regjistruar).

**Punëkërkues i papunë i regjistruar** - është çdo person me vendbanim në Shqipëri, në moshë pune, që regjistrohet si kërkues pune dhe deklaron në Zyrën përkatëse të punësimit që nuk është në marrëdhënie pune ose i vetëpunësuar, si dhe është i aftë dhe i gatshëm për punë.

**Shkalla e punësimit** - është raporti i të Punësuarve (15-64) vjeç kundrejt Popullsisë në moshë pune.

**Shkalla e papunësisë** - është raporti i të Papunëve kundrejt Forcës së punës.

**Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës** - është raporti i Forcës së punës kundrejt Popullsisë në moshë pune.

**Popullsia jo-ekonomikisht aktive** -përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë pra janë jashtë forcës se punës (nxënës/studentë, shtëpiakë, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

## HYRJE

## TË DHËNAT KRYESORE TË TREGUT TË PUNËS

Sipas vlerësimeve nga AFP, për grupmoshën (15-64) vjeç (3 mujori IV 2017/ 3 mujori IV 2016) rezulton se:

- ✓ Pjesëmarrja në Forcën e punës është rritur me **1.7%**. Diferenca e pjesëmarrjes në forcën e punës të Meshkuj/Femrave është rritur nga **16.2%** në **18%**. Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës për të rinjtë është **46.3%**.
- ✓ Shkalla e papunësisë ka rënë me **0.8%** (për Femrat dhe Meshkujt ka rënë me **0.8%,** duke e ngushtuar diferencen gjinore në **0.8%**). Shkalla e papunësisë për të rinjtë ka rënë në **24.6%** nga **28.1%** që ishte në‘2016. Për popullsinë (30-64) vjeç në tremujorin e IV-të 2017, shkalla e papunësisë është **10.5%** nga **10.6%** që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë.
- ✓ Shkalla e punësimit është rritur me **2%**, (për Meshkujt **2.8**, ndërsa për Femrat **1.2%**). Shkalla e punësimit të të rinjve është **34.9%**, ndërsa shkalla e punësimit për moshën (30-64) vjeç është **69.4%.**

Tab.1 Treguesit kryesorë tëTregut të punës

| EMËRTIMI | Tr 4/2016 | Tr 4/2017 |
|---|---|---|
| Shkalla e pjesmarrjes në Forcën e punës | **65.7** | **67.4** |
| Meshkuj | 73.8 | 76.4 |
| Femra | 57.6 | 58.4 |
| Të rinj deri në 29 vjeç | 45.2 | 46.3 |
| Shkalla e Punësimit | **56.2** | **58.2** |
| Meshkuj | 62.8 | 65.6 |
| Femra | 49.6 | 50.8 |
| Të rinj deri në 29 vjeç | 32.5 | 34.9 |
| Shkalla e Papunësisë | **14.5** | **13.4** |
| Meshkuj | 15 | 13.7 |
| Femra | 13.9 | 12.9 |
| Të rinj deri në 29 vjeç | 28.1 | 24.6 |

Burimi: Anketa e Forcës së Punës INSTAT




Fig.1 Shkalla e rritjes së punësimit sipas Aktivitetit ekonomik, Tr. 4 2017/ Tr.4 2016

Tab.2 Treguesit kryesorë të tregut të punës për popullsinë (15-64) vjeç, sipas Qarqeve

| Qarqet | Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës | | | | Shkalla e punësimit | | | | Shkalla e papunësisë | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 | Tr1.17 | Tr2.17 | Tr3.17 | Tr4.17 |
| Shqipëria | 57.3 | 58.1 | 58.7 | 59.1 | 49.2 | 50 | 50.7 | 51.2 | 14.2 | 13.9 | 13.6 | 13.4 |
| Berat | 57.3 | 59.7 | 59.4 | 61.1 | 49.5 | 51.6 | 52.5 | 53.2 | 13.7 | 13.5 | 11.7 | 12.8 |
| Diber | 60.4 | 60.6 | 59.8 | 58.9 | 54.9 | 56.6 | 55.8 | 54.8 | 9.1 | 6.7 | 6.7 | 7 |
| Durrës | 51.4 | 52.1 | 51.2 | 52.9 | 44.8 | 46.4 | 45.2 | 46.4 | 12.9 | 10.8 | 11.9 | 12.2 |
| Elbasan | 68.9 | 67.5 | 68.5 | 66.4 | 61 | 60.2 | 62.2 | 61 | 11.5 | 10.8 | 8.5 | 8.2 |
| Fier | 62.3 | 64.1 | 63.6 | 64.1 | 54.2 | 54.7 | 54.8 | 55.1 | 13 | 14.6 | 13.8 | 14 |
| Gjirokastër | 57.9 | 57.3 | 60 | 59.7 | 51.7 | 49.9 | 52.1 | 52.4 | 10.6 | 12.9 | 13.1 | 12.3 |
| Korçë | 52.3 | 53.7 | 58.5 | 58.6 | 48.1 | 49.6 | 54.2 | 54.2 | 8.1 | 7.6 | 7.3 | 7.5 |
| Kukës | 55.2 | 58.7 | 57.1 | 57 | 46.7 | 50.4 | 49.6 | 50.1 | 15.4 | 14.2 | 13.2 | 12 |
| Lezhe | 56.1 | 56.9 | 56.8 | 54.9 | 47 | 47 | 47.4 | 46 | 16.2 | 17.5 | 16.6 | 16.1 |
| Shkodër | 59.1 | 60.2 | 60.7 | 61.1 | 51.8 | 52.5 | 53.1 | 53.5 | 12.4 | 12.7 | 12.5 | 12.4 |
| Tiranë | 54.1 | 54.5 | 55.3 | 55.9 | 44.7 | 45.6 | 45.9 | 47 | 17.4 | 16.3 | 17 | 16.1 |
| Vlorë | 56.2 | 58.6 | 58.6 | 62.6 | 43.4 | 44.4 | 44.2 | 47.7 | 22.7 | 24.3 | 24.6 | 23.9 |

## KAPITULLI I

# TË DHËNA PËR PUNËKËRKUESIT E REGJISTRUAR

Në bazë të Programit Kombëtar Statistikor, Zyrat Rajonale të Punësimit mbledhin të dhëna[2], mbi punëkërkuesit e regjistruar pranë tyre.

Në kuptim të ligjit, punëkërkuesit kategorizohen në këto Nëngrupe:

- ✓ **Punëkërkues që përfitojnë ndihmë ekonomike** - janë personat, për të cilët është miratuar kërkesa e tyre për përfitimin e ndihmës ekonomike;
- ✓ **Punëkërkues që përfitojnë pagesë papunësie** - Janë personat, për të cilët është miratuar kërkesa e tyre për përfitimin e të ardhurës nga papunësia[3];
- ✓ **Punëkërkues të tjerë** - janë personat, të cilët nuk përfitojnë nga programet e mbështetjes me të ardhura.

Informacioni statistikor përditësohet pas çdo takimi të specialistit të Zyrës se Punës, me çdo punëkërkues.

Informacioni statistikor trajtuar në këtë kapitull, ka të bëje me:

- ✓ Ndryshimet vjetore të Regjistrit të punëkërkuesit;
- ✓ Karakteristikat individuale të punëkërkuesit;
- ✓ Grupet e veçanta të punëkërkuesit;
- ✓ Kategoritë profesionale të punëkërkuesit.

**Shënim:**

- Diferenca midis te dhënave për papunësinë të nxjerra nga ShKP, me ato të marra nga AFP, vjen për shkak se burimet e të dhënave mbulojnë grupe të ndryshme.
- ShKP, regjistron si punëkërkues të papunë vetëm ata të papunë që kërkojnë punë nëpërmjet Zyrave të Punës, por jo të gjithë personat e papunë zgjedhin ta bëjnë këtë.
- Të dhënat e AFP janë më gjithëpërfshirëse duke qenë të projektuara për të përfshirë të gjithë ata që kërkojnë punë aktivisht dhe që janë të gatshëm të punojnë dhe jo vetëm ata që janë regjistruar pranë ShKP.
- Sipas ATFP shumica e të papunëve u drejtohen të afërmve apo miqve/ shokëve për të gjetur një punë (rreth 80% e të papunëve). Të papunët që kërkojnë punë nëpërmjet Zyrave të Punësimit përbejnë vetëm 40% të Totalit.

---

[2]Regjistrimi bëhet në bazë të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dheNenit 8 të Ligjit nr. 146/2015, datë 17. 12. 2015, "Për punëkërkuesit".

[3] Sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë",të ndryshuar.

## I.1 NDRYSHIMI VJETOR I REGJISTRIT TË PUNËKËRKUESIT

Sipas të dhënave të burimeve administrative, rezulton së në fund të '2017, janë regjistruar pranë Zyrave të Punësimit **83,497** punëkërkues të papunë nga **93,889** që ishin në fund të'2016.




Fig.2 Dinamika e uljes së Numrit të PU.PA sipas Muajve




Fig.3 Numri i PU.PA sipas Grupeve të papunësisë

Tab.3 Bilanci vjetor i papunësisë së regjistruar sipas Qarqeve

| RAJONET | Gjendje në fillim | Hyrje | | | | Dalje | | | | Gjendje në fund | Ndryshimi ne % |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Gjithsej | Pagesa e papunësisë | Ndihma ekonomike | Grupi të tjerë | Gjithsej | Pagesa e papunësisë | Ndihma ekonomike | Grupi të tjerë | | |
| BERAT | 4022 | 2560 | 242 | 603 | 1715 | 3412 | 263 | 537 | 2612 | 3170 | -21% |
| DIBER | 4522 | 3270 | 182 | 646 | 2442 | 2983 | 322 | 550 | 2111 | 4809 | 6% |
| DURRES | 8289 | 8228 | 330 | 481 | 7417 | 9518 | 399 | 327 | 8792 | 6999 | -16% |
| ELBASAN | 12415 | 5765 | 624 | 378 | 4763 | 8860 | 795 | 1344 | 6721 | 9320 | -25% |
| FIER | 10803 | 10691 | 261 | 708 | 9722 | 8371 | 329 | 684 | 7358 | 13123 | 21% |
| GJIROK | 3465 | 3210 | 186 | 200 | 2824 | 3152 | 205 | 185 | 2762 | 3523 | 2% |
| KORCE | 7842 | 4543 | 546 | 1078 | 2919 | 5932 | 811 | 1133 | 3988 | 6453 | -18% |
| KUKES | 7700 | 2591 | 403 | 1145 | 1043 | 3945 | 741 | 2122 | 1082 | 6346 | -18% |
| LEZHE | 5933 | 4423 | 378 | 1078 | 2967 | 5340 | 34 | 1313 | 3993 | 5016 | -15% |
| SHKODER | 7920 | 6685 | 519 | 456 | 5710 | 7550 | 618 | 868 | 6064 | 7055 | -11% |
| TIRANE | 15769 | 15581 | 1218 | 4069 | 10294 | 17478 | 1453 | 3975 | 12050 | 13872 | -12% |
| VLORE | 5209 | 5553 | 279 | 266 | 5008 | 6951 | 343 | 377 | 6231 | 3811 | -27% |
| GJITHSEJ | 93889 | 73100 | 5168 | 11108 | 56824 | 83492 | 6313 | 13415 | 63764 | 83497 | -11% |

Numri i punëkërkuesve të papunë është ulur me **11%**. Rajoni me uljen më të madhe rezulton Vlora me **27%**.

Nga kategoria e individëve që kanë humbur statusin e PU.PA, numri i individëve që përfitonin pagesë papunësie është **6,313** persona ose **28%** më pak se një vit më parë, ndërsa numri i personave që përfitonin ndihmë ekonomike është **13,415** persona ose **49.8%** më pak se një vit më parë.




Fig.4 Numri i PU.PA të çrregjistruar sipas arsyeve

## I.2Karakteristikat Individuale të Pu.Pa.

### A. GRUPMOSHA

Mosha e PU.PA është grupuar në tetë intervale, secili me kohështrirje 5 vjeçare. Vlen për tu theksuar se **63**% të PU.PA të regjistruar, janë të grupmoshës mbi 40 vjeç**.**

Tab.4 Struktura moshore e PU.PA sipas Qarqeve (%)

| QARQET | 15 - 19 vjeç | 20 - 24 vjeç | 25 - 29 vjeç | 30 - 34 vjeç | 35 - 39 vjeç | 40 - 44 vjeç | 45 - 50 vjeç | mbi 50 vjeç |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 1.8 | 4.9 | 5.7 | 5.4 | 6.5 | 8.3 | 14.4 | 53.1 |
| DIBER | 5.1 | 8.6 | 12.9 | 17.2 | 16.0 | 11.5 | 12.6 | 16.2 |
| DURRES | 2.6 | 8.0 | 7.3 | 6.7 | 6.9 | 9.2 | 14.7 | 44.6 |
| ELBASAN | 2.5 | 6.8 | 8.9 | 8.9 | 10.5 | 9.8 | 11.9 | 40.6 |
| FIER | 1.9 | 8.1 | 8.3 | 7.6 | 8.3 | 9.5 | 14.2 | 42.1 |
| GJIROKASTER | 1.6 | 9.2 | 11.0 | 10.4 | 9.7 | 8.5 | 12.7 | 37.0 |
| KORCE | 1.5 | 8.4 | 9.5 | 9.1 | 9.2 | 10.1 | 13.1 | 39.1 |
| KUKES | 3.9 | 15.0 | 13.1 | 10.0 | 10.9 | 12.7 | 13.8 | 20.5 |
| LEZHE | 2.0 | 6.7 | 6.6 | 6.9 | 8.9 | 12.8 | 17.2 | 39.0 |
| SHKODER | 5.2 | 10.3 | 7.3 | 6.2 | 7.1 | 10.7 | 15.2 | 38.1 |
| TIRANE | 1.5 | 4.5 | 6.7 | 8.8 | 10.0 | 9.7 | 16.4 | 42.5 |
| VLORE | 1.6 | 6.1 | 7.2 | 8.3 | 9.8 | 10.2 | 12.4 | 44.4 |
| **GJITHSEJ VËNDI** | **2.5** | **7.9** | **8.5** | **8.6** | **9.4** | **10.2** | **14.3** | **38.6** |

Krahasuar me '2016, ka një rënie të PU.PA., në të gjitha grupmoshat, por më e theksuar është rënia në kategorinë 45-50 vjeç.




Fig.5 Numri i PU.PA.,të regjistruar sipas Grupmoshave 2016/2017

## B. NIVELI ARSIMOR

Vitet e arsimit të papunëve janë klasifikuar në 6 Nivele: Më pak se Arsimi Fillor; Arsimi Fillor; Arsimi Bazë 9 vjeçar; Gjimnaz; E mesme profesionale dhe Arsimi i Lartë.

Vlen për të theksuar se PU.PA me arsim deri në 9 vjeçar përbejnë 57% të Totalit të PU.PA të regjistruar.

Tab.5 Struktura arsimore e PU.PA sipas Qarqeve

| QARQET | Më pak se ArsimiFillor | Arsimi Fillor | Arsimi Bazë | Gjimnaz. | E mesme profesionale | Arsimi i Lartë |
|---|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 3.3 | 3.4 | 45.8 | 23.8 | 20.6 | 3.0 |
| DIBER | 3.6 | 5.3 | 49.8 | 28.0 | 8.4 | 4.9 |
| DURRES | 3.1 | 4.2 | 52.1 | 22.8 | 10.3 | 7.5 |
| ELBASAN | 2.5 | 5.0 | 59.0 | 18.9 | 10.5 | 4.0 |
| FIER | 1.9 | 2.2 | 46.8 | 29.2 | 13.5 | 6.4 |
| GJIROKASTER | 3.5 | 2.2 | 43.8 | 33.8 | 8.5 | 8.1 |
| KORCE | 2.8 | 9.4 | 46.2 | 28.6 | 7.8 | 5.3 |
| KUKES | 0.3 | 2.6 | 42.0 | 40.2 | 6.4 | 8.4 |
| LEZHE | 2.2 | 4.7 | 54.2 | 30.8 | 5.2 | 2.9 |
| SHKODER | 1.0 | 5.0 | 51.8 | 26.3 | 10.0 | 5.8 |
| TIRANE | 6.1 | 6.0 | 48.7 | 24.0 | 9.5 | 5.7 |
| VLORE | 2.0 | 3.4 | 51.8 | 27.2 | 8.4 | 7.1 |
| **GJITHSEJ VËNDI** | **2.9** | **4.6** | **49.4** | **27.2** | **10.0** | **5.8** |

Krahasuar me '2016, kemi një rënie me **19%** të grupit të PU.PA me Arsimi të Lartë (nga **6,018** në **4,860**).




Fig.6 Numri i PU.PA, të regjistruar sipas Nivelit arsimor 2016/2017

## C. GJINIA

Në fund të ‘2017, rezulton se janë regjistruara **44,220** punëkërkuese të papuna Femra ose **53%** e Totalit. Më shumë PU.PA ferma të regjistruara ka Fieri **me 57%** të Totalit dhe më pak ka Berati, Dibra dhe Shkodra me **49%** të Totalit.




Fig.7 Punëkërkues të papunë sipas Gjinisë dhe Qarqeve

PU.PAFemra, në skemat e mbështjes me të ardhura, përbëjnë **48%** tëTotalit, ndërkohë që për Femrat kryefamiljare, kjo shifër shkon në rreth **64%.**




Fig.8 PU.PA Femra kryefamiljarë sipas Grupeve të papunësisë

Tab.6 PU.PA Femra sipas Karakteristikave individuale

| Emërtimi | Gjithsej | Deri në 29 vjeç | 30 - 39 vjeç | mbi 40 vjeç | Arsim deri në 9 vjeçar | Arsim mesëm | Arsim universitare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjithsej | 100 | 17.5 | 19.4 | 63.0 | 56.4 | 36.4 | 7.2 |
| Përfitojnë Pagese papunësie | 100 | 17.0 | 22.1 | 60.9 | 23.2 | 49.0 | 27.7 |
| Përfitojnë Ndihmë ekonomike | 100 | 17.1 | 22.7 | 60.3 | 65.9 | 31.0 | 3.1 |
| Afatgjatë | 100 | 15.5 | 20.0 | 64.5 | 57.0 | 39.2 | 3.8 |
| Romë | 100 | 25.9 | 26.4 | 47.7 | 98.4 | 1.6 | 0.0 |
| Egjiptianë | 100 | 27.5 | 24.2 | 48.3 | 93.3 | 6.3 | 0.4 |
| Aftësi të kufizuar | 100 | 16.4 | 21.7 | 61.9 | 60.2 | 38.1 | 1.8 |
| Emigrantë të kthyer | 100 | 23.2 | 33.1 | 43.6 | 42.5 | 49.7 | 7.7 |

## I.3 GRUPET E VECANTA TE PU.PA.

Kategorizimi i grupeve “të veçanta” të punëkërkuesve të papunë të disavantazhuar në Tregun e punës, i realizuar sipas përcaktimeve ligjore[4] përmban:

a. jetimë;
b. kryefamiljarë të vetëm me fëmijë në ngarkim;
c. persona me aftësi të kufizuar;
d. persona me moshë mbi 55 vjeç;
e. persona nga komuniteti Rom dhe Egjiptian;
f. persona që kanë apo janë duke vuajtur dënimin me burgim;
g. persona që përfitojnë nga Programet e mbështetjes me të ardhura, (personat përfitues të Ndihmës ekonomike, individualisht apo si pjesëtarë të familjes në Ndihmë Ekonomike (Dr.Pol.Soc.);
h. punëkërkues të papunë afatgjatë (të regjistruar si punëkërkues të papunë prej më shumë se një viti);
i. punëkërkues të papunë të kthyer prej jo më shumë se dy vjetësh nga emigracioni;
j. “Riintegrimi Social” është Programi që synon punësimin apo krijimin e kushteve për punësim dhe vetëpunësim të përfituesve të Ndihmës Ekonomike të aftë për punë (Dr.Pol.Soc.);
k. të mitur dhe të rinjtë në konflikt me ligjin;
l. të rinjtë me moshë nën 29 vjeç;
m. viktimat e trafikut dhe të dhunës me bazë gjinore dhe në familje.

[4] Ligjit nr. 9570 dt 03.07.2006, “Për Nxitjen e Punësimit”

Sipas po këtij ligji, këto kategori kanë përparësi në përfshirjen në të gjitha politikat aktive shtetërore që zbaton institucioni ShKP. Pjesa me e madhe e tyre trajtohen në Nivelin e III-të të shërbimeve të punesimit me këshillim të individualizuar.

Në vijim të dhëna specifike për çdo grup:

## A. PU.PA AFATGJATË

Një PU.PA kategorizohet afatgjatë**,** nëse ka mbi një vit që kërkon punë. Përqindja që zënë të papunët afatgjatë ndaj Totalit të papunëve të regjistruar është një nga treguesit e rëndësishëm të Tregut të punës. Për vitin 2000, të papunët afatgjatë përbënin **89.6%** të Totalit të papunëve të regjistruar, ndërsa në vitet më pas deri në '2011, kjo përqindje ulet deri në **62.3 %.**

Në fund të'2017, rezultojnë të regjistruar si PU.PA afatgjatë **42,594** vetë ose **51%** e Totalit.




Fig.9 PU.PA afatgjatë sipas periudhës së Afatgjatësisë në papunësi

Në vijim mund të shikojmë karakteristikat e papunësisë afatgjatë sipas afatgjatësisë në papunësi dhe sipas Qarqeve.

Tab.7 PU.PA afatgjatë sipas karakteristikave individuale

| EMËRTIMI | Femra | Krye familjare | deri në 29 vjeç | 30 - 39 vjeç | mbi 40 vjeç | Arsim deri në 9 vjeçar | Arsim mesëm | Arsim universitare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Gjithsej** | 50.7 | 40.3 | 16.2 | 19.2 | 64.6 | 59.0 | 37.8 | 3.2 |
| **prej 1 -3 vjetësh** | 51.2 | 40.4 | 16.6 | 19.3 | 64.1 | 60.1 | 36.6 | 3.3 |
| **Mbi 3 vjet** | 50.1 | 40.0 | 15.6 | 19.1 | 65.3 | 57.4 | 39.7 | 2.9 |




Fig.10 PU.PA të regjistruar afatgjatë sipas Periudhës së afatgjatësisë dhe Qarqeve

## B. PU.PA ROMË

Në fund të '2017, rezultuan të regjistruar si PU.PA Romë **2,270** vetë ose **2.7%** e Totalit.

Nga totali i PU.PA Romë **48.4%** janë Femra dhe **44.8 %** kryefamiljarë. Për këtë kategori është hartuar dhe "Strategjia kombëtare për përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit Rom", sipas të cilës ShKP monitoron përfshirjen e kësaj kategorie në politikat shtetërore të punësimit.







Fig.11 PU.PA të regjistruar Romë sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor

Tab.8 PU.PA Romë sipas Qarqeve

| QARQET | Gjithsej | Prej tyre në % ndaj Totalit | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Total | Femra | Kryefamiljarë |
| BERAT | 111 | 100 | 51.4 | 20.7 |
| DIBER | 0 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| DURRES | 210 | 100 | 51.9 | 45.7 |
| ELBASAN | 481 | 100 | 48.9 | 49.9 |
| FIER | 224 | 100 | 52.2 | 46.4 |
| GJIROKASTER | 108 | 100 | 55.6 | 2.8 |
| KORCE | 227 | 100 | 52.0 | 52.4 |
| KUKES | 90 | 100 | 53.3 | 23.3 |
| LEZHE | 114 | 100 | 44.7 | 48.2 |
| SHKODER | 68 | 100 | 52.9 | 42.6 |
| TIRANE | 563 | 100 | 41.0 | 52.0 |
| VLORE | 74 | 100 | 48.6 | 44.6 |
| GJITHSEJ VËNDI | 2270 | 100 | 48.4 | 44.8 |

## C. PU.PA EGJIPTIANË

Në fund të '2017, rezultuan të regjistruar si PU.PA Egjiptianë **3,749** vetë ose **4.5%** e Totalit. Nga totali i PU.PA Egjiptianë **54.1%** janë Femra dhe **44.8 %** kryefamiljarë.







Fig.12 PU.PA të regjistruar Egjiptianë sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor

Tab.9 PU.PA Egjiptianë sipas Qarqeve

| QARQET | Gjithsej | Prej tyre në % ndaj Totalit | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Total | Femra | Kryefamiljarë |
| BERAT | 310 | 100 | 52.3 | 60.3 |
| DIBER | 258 | 100 | 46.9 | 37.2 |
| DURRES | 275 | 100 | 54.9 | 51.3 |
| ELBASAN | 339 | 100 | 65.8 | 49.6 |
| FIER | 360 | 100 | 53.6 | 29.7 |
| GJIROKASTER | 103 | 100 | 43.7 | 4.9 |
| KORCE | 715 | 100 | 49.1 | 53.1 |
| KUKES | 34 | 100 | 38.2 | 29.4 |
| LEZHE | 262 | 100 | 41.6 | 55.0 |
| SHKODER | 231 | 100 | 53.7 | 45.9 |
| TIRANE | 862 | 100 | 62.2 | 39.0 |
| VLORE | 0 | 0 | 0.0 | 0.0 |
| GJITHSEJ VËNDI | 3749 | 100 | 54.1 | 44.8 |

## D. PU.PA ME AFTËSI TE KUFIZUAR (PAK)

Në fund të '2017, rezultojnë të regjistruar si PU.PA nga kjo kategori **472** vetë nga **552** që kanë qenë në fundin e '2016.

Shqipëria ka ratifikuar Konventën e OKB-së, mbi të drejtat e personave me AK që në dhjetor të '2012, ndërkohë që kjo konventë është depozituar si e pranuar në OKB në shkurt të '2013. Një nga të drejtat thelbësore të kësaj konvente është dhe e drejta për Punësim dhe Formim.

Në ligjin e nxitjes së punësimit, personat me aftësi të kufizuar janë grup i synuar për përfshirjen në të gjitha programet shtetërore të nxitjes se punësimit dhe formimit profesional.

Nga totali i PU.PA me aftësi të kufizuar **47.9%** janë Femra dhe **42.2%** kryefamiljarë.




Fig.13 PU.PA PAK të regjistruar sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor




Fig.14 PU.PA me aftësi të kufizuar, sipas Qarqeve

## E. PU.PA EMIGRANTË TË KTHYER

Emigrantët e kthyer janë një tjetër kategori e veçantë, e cila erdhi në fokus të politikave të punësimit në vitin 2010, kur me përshkallëzimin e krizës ekonomike në botë, shumë shqiptarë në emigrim, filluan të kthehen. Në zbatim të planit të masave të Strategjisë për ri integrimin e Shtetasve shqiptarë të kthyer, si pjesë e politikave kombëtare për migracionin janë krijuar sportele të emigracionit në të gjitha Zyrat e Punësimit. Ato ofrojnë këshillim, informim, ndërgjegjësim mbi situatën e Tregut të punës me qëllim riintegrimin dhe punësimin sa më të shpejtë të tyre.

Të dhënat për Emigrantët e kthyer i përkasin punëkërkues të papunë të kthyer prej jo më shumë se dy vjetësh nga emigracioni.

Në fund të '2017, figurojnë të regjistruar në Zyrat e Punësimit **530** emigrantë të kthyer, nga të cilët **291** janë regjistrime të reja të '2017.




Fig.15 PU.PA Emigrantë sipas karakteristikave të kthimit




Fig.16 PU.PA emigrantë të kthyer sipas karakteristikave individuale

Tab.10 PU.PA emigrantë, të kthyer sipas Qarqeve

| QARQET | Gjithsej | deri në 29 vjeç | 30 - 39 vjeç | mbi 40 vjeç | deri në 9 vjeçar | Mesme | Universitare |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 100 | 28.6 | 14.3 | 57.1 | 42.9 | 42.9 | 14.3 |
| DIBER | 100 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 | 0.0 |
| DURRES | 100 | 22.9 | 40.0 | 37.1 | 40.0 | 48.6 | 11.4 |
| ELBASAN | 100 | 33.3 | 38.9 | 27.8 | 69.4 | 27.8 | 2.8 |
| FIER | 100 | 24.6 | 40.4 | 35.1 | 43.9 | 54.4 | 1.8 |
| GJIROKASTER | 100 | 0.0 | 0.0 | 100.0 | 71.4 | 28.6 | 0.0 |
| KORÇE | 100 | 11.4 | 22.7 | 65.9 | 59.1 | 38.6 | 2.3 |
| KUKES | 100 | 43.4 | 45.3 | 11.3 | 24.5 | 60.4 | 15.1 |
| LEZHE | 100 | 11.4 | 40.0 | 48.6 | 54.3 | 45.7 | 0.0 |
| SHKODER | 100 | 37.8 | 28.9 | 33.3 | 51.1 | 48.9 | 0.0 |
| TIRANE | 100 | 15.2 | 25.3 | 59.6 | 47.5 | 46.5 | 6.1 |
| VLORE | 100 | 15.4 | 23.1 | 61.5 | 69.2 | 23.1 | 7.7 |
| GJITHSEJ VËNDI | 100 | 22.1 | 31.3 | 46.6 | 48.3 | 46.2 | 5.5 |




Fig.17 PU.PA emigrantë, të kthyer sipas mbështetjes së kërkuar për ri integrim

## I.4 Kategoritë Profesionale të PU.PA-ve

Profesionet e vlerësuara të Punëkërkuesve të papunë, referuar aftësive dhe kualifikimeve që ata kanë fituar gjatë arsimimit, apo përvojës së punës, janë klasifikuar sipas Listës Kombëtare të Profesioneve[5].

Të dhënat për profesionet e punëkërkuesve të papunë, mblidhen sipas **10** Grupeve.

**Grupet kryesore në klasifikimin e profesioneve:**

1. Ligjvënës, nëpunës të lartë të administratës shtetërore dhe drejtues ekzekutiv;
2. Specialistë më arsim të lartë;
3. Teknikë dhe specialistë në zbatim;
4. Nëpunës të thjeshtë;
5. Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve;
6. Punonjës të bujqësisë pyjeve dhe peshkimit;
7. Zejtarë, zanatçinj dhe profesioneve të lidhura me to;
8. Punonjës të montimit dhe përdorimit të makinerive dhe pajisjeve;
9. Punëtorë të ndihmës (profesione elementare);
10. Forcat e armatosura.

Për secilin grup ka Nëngrupe të mëdha (total 37) që i përkasin fushës së aktivitetit.

[5]Miratuar me Vendim te Këshillit te Ministrave nr. 627 dt 11.06.2009




Fig.18 PU.PA sipas kategorive kryesore profesionale

Tab.11 PU.PA sipas kategorive profesionale

| EMËRTIMET E GRUP PROFESIONEVE | Numri i PU.PA Gjithsej | Femra | pagesë papunës | ndihmë ekonomi | afatgjate | rome/ egjiptia | aftesi te kufizuar | emigrant |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1. Menaxherë** | 62 | 17 | 5 | 6 | 0 | 0 | 3 | 6 |
| **2. Specialistë me arsim të lartë** | 5360 | 3597 | 361 | 972 | 1611 | 16 | 20 | 23 |
| - të shkencave të fizikës matematikës dhe inxhinierisë | 603 | 374 | 73 | 70 | 104 | 1 | 1 | 1 |
| - të shendetësisë | 817 | 586 | 36 | 165 | 308 | 2 | 2 | 2 |
| - të mësimdhënies | 1477 | 1083 | 66 | 268 | 575 | 4 | 4 | 8 |
| - të administrimit dhe të biznesit | 721 | 415 | 122 | 167 | 167 | 0 | 7 | 3 |
| - të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit | 459 | 257 | 26 | 97 | 117 | 1 | 5 | 7 |
| - të fushës ligjore shoqërore dhe kulturore | 1283 | 882 | 38 | 205 | 340 | 8 | 1 | 2 |
| **3. Teknikë dhe specialistë të mesëm** | 3118 | 1570 | 130 | 989 | 1410 | 13 | 23 | 11 |
| - bashkëpunëtorë profesionistë në inxhinieri dhe shkencë | 679 | 284 | 40 | 166 | 337 | 0 | 4 | 3 |
| - asistentë të specializuar të shendetësisë | 408 | 188 | 12 | 132 | 201 | 0 | 3 | 2 |
| - asistentë në administrim dhe biznes | 842 | 467 | 33 | 258 | 367 | 1 | 5 | 4 |
| - specialist ligjor, shoqëror, kulturor, të rendit | 724 | 413 | 26 | 314 | 346 | 10 | 3 | 0 |
| - teknikë të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit | 465 | 218 | 19 | 119 | 159 | 2 | 8 | 2 |
| **4. Nëpunës** | 1629 | 877 | 123 | 613 | 740 | 17 | 16 | 15 |
| - nëpunës zyrash | 760 | 406 | 82 | 270 | 340 | 7 | 7 | 2 |
| - nëpunës të shërbimit të klientëve | 869 | 471 | 41 | 343 | 400 | 10 | 9 | 13 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **5. Punonjës të shitjeve dhe të shërbimeve** | 10489 | 6596 | 290 | 3110 | 3037 | 197 | 33 | 45 |
| - të shërbimeve personale dhe të mbrojtjes | 5460 | 3277 | 147 | 1580 | 1387 | 108 | 14 | 21 |
| - punonjës shitje | 5029 | 3319 | 143 | 1530 | 1650 | 89 | 19 | 24 |
| **6. Punonjës të kualifikuar të bujqësisë pyjeve dhe të peshkimit** | 2195 | 1355 | 8 | 1324 | 1229 | 33 | 10 | 31 |
| **7. Zejtarë zanatçinjtë dhe profesione të lidhura me to** | 13674 | 4475 | 348 | 6529 | 6010 | 419 | 62 | 144 |
| - punonjës të ndërtimit | 5326 | 668 | 133 | 3055 | 2560 | 111 | 16 | 72 |
| - punonjës të punimit të metaleve dhe montimit të makinerive | 2390 | 327 | 45 | 826 | 1153 | 71 | 7 | 6 |
| - punonjës të prodhimit artizanal dhe shtypshkrimit etj | 1101 | 608 | 31 | 556 | 443 | 99 | 8 | 5 |
| - punonjës në profesionet e elektro-teknologjisë | 1220 | 310 | 68 | 485 | 526 | 8 | 6 | 17 |
| - punonjës të përpunimit të ushqimit, drurit, tekstileve etj | 3637 | 2562 | 71 | 1607 | 1328 | 130 | 25 | 44 |
| **8. Punonjës në industri** | 5271 | 907 | 228 | 2501 | 2708 | 127 | 19 | 29 |
| - punonjës të minierave dhe përpunimit të metaleve | 2354 | 744 | 151 | 1335 | 1348 | 94 | 12 | 5 |
| - montues | 404 | 14 | 19 | 181 | 176 | 2 | 1 | 0 |
| - drejtues automjeti dhe punëtor të makinave industriale | 2513 | 149 | 58 | 985 | 1184 | 31 | 6 | 24 |
| **9. Profesione elementare** | 34092 | 20791 | 390 | 18689 | 21060 | 3309 | 219 | 209 |
| - punëtor shërbimi dhe ndihmës | 6400 | 4363 | 111 | 3445 | 3636 | 668 | 73 | 52 |
| - punëtor të bujqësisë pyjeve dhe të peshkimit | 4440 | 2967 | 40 | 2131 | 2725 | 157 | 14 | 23 |
| - punëtor në miniera, ndërtim, industri e transport | 13857 | 7305 | 135 | 6660 | 8761 | 1002 | 61 | 80 |
| - ndihmës në përgatitjen e ushqimit | 2117 | 1546 | 25 | 1279 | 1079 | 77 | 18 | 16 |
| - punëtor për shitje dhe shërbime të ndryshme në rrugë | 2618 | 1873 | 32 | 1774 | 1639 | 292 | 15 | 15 |
| - mbledhës plehrash dhe punëtor të shërbimeve të tjera elementare | 4660 | 2737 | 47 | 3400 | 3220 | 1113 | 38 | 23 |
| **10. Forcat e armatosura** | 451 | 51 | 17 | 54 | 182 | 0 | 0 | 0 |
| - oficer të forcave të armatosura | 247 | 19 | 7 | 9 | 94 | 0 | 0 | 0 |
| - nënoficerë dhe të tjerë në forcat e armatosura | 204 | 32 | 10 | 45 | 88 | 0 | 0 | 0 |
| Pa profesion | 7156 | 3984 | 59 | 4505 | 4607 | 1888 | 67 | 17 |
| **Totali** | **83497** | **44220** | **1959** | **39292** | **42594** | **6019** | **472** | **530** |




Fig.19 PU.PA të regjistruar sipas Profesioneve dhe Qarqeve

## KAPITULLI II

# TË DHËNA PER OFERTËN PËR PUNË

Punëdhënësit janë një tjetër klient shumë i rëndësishëm i Zyrave të Punësimit. Bazuar në ligjin Nr. 7995 Datë 20.09.1995, "Për nxitjen e punësimit", burimi i të dhënave për punëdhënësit duhet të ishte Regjistri i bizneseve i krijuar dhe administruar nga Zyrat e Punësimit në rrethe.

Me ndryshimet e bazës ligjore, e ndodhur në vitet e fundit, për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, jo të gjitha bizneset paraqiten pranë Zyrave të Punës për të deklaruar ndryshimet e fuqisë punëtore edhe pse sipas ligjit të sipërcituar ky është detyrim ligjor. Kjo ka bërë që në këto regjistra të figurojnë të dhëna vetëm për **30%** të bizneseve aktive të raportuar nga tatimet e që detyron ShKP, që të kërkojë një burim tjetër të dhënash. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është aktualisht institucioni i vetëm në vend ku bizneset deklarojnë të gjitha të dhënat e tyre. Mbështetur nga urdhri brendshëm i drejtorit të përgjithshëm të tatimeve, këto të dhëna merren pranë zyrave të tatimeve në rrethe.

Pra, të dhënat për punëdhënësit sigurohen nëpërmjet dy burimeve të informacionit:

- ✓ Drejtoritë e tatimeve në rrethe (çdo 3 muaj);
- ✓ Regjistri i punëdhënësit në Zyrat e Punësimit.

Regjistri i punëdhënësit përditësohet bazuar në:

- ✓ Vizitat e specialistëve në subjekte;
- ✓ Kontakteve me përfaqësuesit e bizneseve në ambientet e Zyrës së Punës;
- ✓ Marrjen e informacionit nëpërmjet telefonit, E-mail-it etj.

Informacioni statistikor në këtë kapitull ka të bëje me:

- ✓ Karakteristikat e përgjithshme të biznesit;
- ✓ Vendet e lira të regjistruara në Zyrat e Punësimit;
- ✓ Lejet e punës dhe Vërtetimet e punësimit për të huajt.

## II.1 KARAKTERISTIKAT E PERGJITHSHME TE BIZNESIT

Sipas të dhënave në fund të ‘2017, rezultojnë të regjistruara me aktivitet ekonomik aktiv këto subjekte:

Tab.12 Të dhëna për subjektet dhe të punësuarit

| EMËRTIMI | Viti 2015 | Viti 2016 | Viti 2017 | 2017/2016 në % |
|---|---|---|---|---|
| Ndërmarrje gjithsej | 93,145 | 110,976 | 42,495 | 38.3% |
| Ndërmarrje në sektorin shtetëror | 2,022 | 2,079 | 923 | 44.4% |
| Ndërmarrje në sektorin privat jo bujqësor | 91,123 | 108,897 | 41,572 | 38.2% |
| Punonjës gjithsej | 557,810 | 588,719 | 479,161 | 81.4% |
| Punonjës në sektorin shtetëror | 162,633 | 166,100 | 84,798 | 51.1% |
| Punonjës në sektorin privat jo bujqësor | 395,177 | 422,619 | 394,363 | 93.3% |




Fig.20 Punësimi sipas Pronësisë së subjektit

Në Zyrat e Punësimit, rezultojnë të jenë të regjistruar rreth **42,495** subjekte, shifër kjo rreth **11%** më e lartë se një vit më parë, por që përfaqëson vetëm **37%** të Totalit të subjekteve të deklaruara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatim Taksave që rezultojnë aktive.

Tab.13 Të dhëna për subjektet sipas Rajoneve

| RAJONET | Ndërmarrje private | Ndërmarrje shtetërore | Totali |
|---|---|---|---|
| Berat | 96.6 | 3.4 | 100 |
| Dibër | 86.4 | 13.6 | 100 |
| Durrës | 98.6 | 1.4 | 100 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **Elbasan** | 97.2 | 2.8 | 100 |
| **Fier** | 97.8 | 2.2 | 100 |
| **Gjirokastër** | 93.0 | 7.0 | 100 |
| **Korçë** | 96.4 | 3.6 | 100 |
| **Kukës** | 92.2 | 7.8 | 100 |
| **Lezhë** | 97.0 | 3.0 | 100 |
| **Shkodër** | 96.9 | 3.1 | 100 |
| **Tiranë** | 99.9 | 0.1 | 100 |
| **Vlorë** | 97.2 | 2.8 | 100 |
| **TOTAL** | **97.8** | **2.2** | **100** |




Fig.21 Subjektet e regjistruara në ZP, sipas aktiviteteve ekonomike

Tab.14 Subjektet private të regjistruara në ZP, sipas Madhësisë dhe Aktivitetit ekonomik

| LLOJI I AKTIVITETIT | deri në 9 punonjës | 10-49 punonjës | 50-249 punonjës | mbi 250 punonjës |
|---|---|---|---|---|
| Bujqësi, pylltari dhe peshkim | 76.2 | 18.5 | 5.0 | 0.3 |
| Miniere dhe gurore | 49.6 | 39.9 | 9.7 | 0.8 |
| Industria përpunuese (a+b+c+d) | 74.8 | 15.1 | 8.5 | 1.6 |
| Elektrik, gaz, pajisje rryme ajër i kondicionuar | 74.3 | 17.7 | 7.0 | 0.9 |
| Pajisje uji; largim ujëra te zeza, menaxhim plehrave | 77.2 | 19.9 | 2.2 | 0.7 |
| Ndërtim | 68.5 | 26.4 | 4.7 | 0.5 |
| Tregti me shumice dhe pakice; riparim | 90.7 | 8.0 | 1.2 | 0.1 |
| Transport dhe magazinim | 92.3 | 6.3 | 1.3 | 0.1 |
| Aktivitete strehimi dhe shërbimi ushqimor | 87.4 | 9.7 | 2.2 | 0.7 |
| Informacion dhe komunikacion | 73.7 | 17.1 | 6.5 | 2.7 |
| Aktivitete financiare dhe sigurimesh | 85.4 | 12.3 | 1.8 | 0.6 |
| Aktivitete pasurish te patundshme | 81.3 | 13.6 | 4.4 | 0.6 |
| Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike | 88.3 | 7.5 | 3.5 | 0.7 |
| Aktivitete administratë. shërbime mbështetëse | 82.4 | 12.6 | 4.7 | 0.3 |
| Administrate publike dhe mbrojtje; | 80.9 | 14.2 | 4.0 | 0.9 |
| Arsim | 72.1 | 20.9 | 4.7 | 2.2 |
| Aktivitete te shëndetit njerëzor / pune sociale | 93.2 | 6.1 | 0.5 | 0.1 |
| Arte, zbavitje dhe çlodhje | 86.8 | 10.7 | 1.5 | 1.0 |
| Aktivitete shërbimesh te tjera | 91.9 | 6.7 | 1.1 | 0.2 |
| Aktivitete te kryefamiljareve si punëdhënës; | 99.3 | 0.0 | 0.4 | 0.4 |
| Aktivitete te organizatave eksterritoriale | 86.7 | 13.3 | 0.0 | 0.0 |
| **SHUMA TOTALE** | **85.6** | **11.1** | **2.8** | **0.5** |

Nga **41,572** subjektet private të regjistruara në Zyrën e Punësimit, rezultojnë të kenë **394,363** të punësuar, nga të cilët **48.7%** janë Femra.

Subjektet private të regjistruara në Zyrën e Punësimit, me pronësi të përbashkët apo të huaj, përbëjnë vetëm **7%** të Totalit.







Fig.22 Subjektet e regjistruara në ZP me Pronësi të përbashkët apo të huaj, sipas Qarqeve




Fig.23 Subjektet e regjistruara në ZP me Pronësi të përbashkët apo të huaj, sipas Madhësisë

Bizneset e mëdha zhvillojnë aktivitetin në degët e industrisë përpunuese, ndërtim, shërbimeve administrative (call center) dhe aktivitete financiare. Ndërsa bizneset e vogla janë të fokusuara pothuajse në të gjithë spektrin e aktiviteteve ekonomike.

## II.2 VENDET E LIRA TË REGJISTRUARA NË ZYRAT E PUNËSIMIT

Të dhënat për vendet e lira të shpallura në Zyrat e Punësimit, sigurohen nga Regjistri i vendeve të lira të punës që disponojnë Zyrat e Punësimit.

Regjistri i vendeve te lira përditësohet bazuar në:

- ✓ Inspektimet e specialistëve në subjekte;
- ✓ Kontaktet me përfaqësuesit e bizneseve në mjediset e Zyrës së Punës;
- ✓ Informacioni imarrë me telefon, E-mail etj.

| Emërtimi | 2016 | 2017 |
|---|---|---|
| Kontakte me punëdhënësit | 52733 | 67472 |
| a. në zyrën e punësimit | 35204 | 40684 |
| b. në ndërmarrje: | 17529 | 26667 |
| - Vizita të reja | 2528 | 8055 |
| - Vizita të përsëritura | 14997 | 18596 |

Tab.15 Kontaktet me punëdhënësit sipas mënyrës së kontaktimit

Rezultojnë në total **14,739** kontakte më shumë krahasuar me një vit më parë. Nga kontaktet me punëdhënësin janë siguruar **40,013** oferta pune, ose **4%** më shumë se një vit më parë. Në referim të mënyrës së sigurimit të ofertave dhe llojit të tyre, **30,299** janë poste të reja pune dhe **61.2%** e ofertave janë marrë nga vizitat në ndërmarrje.

Vihet re një rritje prej **24%** i vendeve të lira të marra nga vizitat në ndërmarrje (nga **18,466** në 2016 në **22,806** në 2017).

Rajonet me produktivitetin më të lartë të vizitave në ndërmarrje, për sa i përket finalizimit me marrjen e vendit të lirë, janë Durrësi, Elbasani, Fieri, Lezha, Tirana dhe Shkodra.




Fig.24 Numri i kontakteve me punëdhënësin si dhe vendet e lira të marra sipas Qarqeve




Fig.25 Vendet e reja te punës të shpallura, sipas aktiviteteve ekonomike

Grafiku i mësipërm paraqet se në cilat aktivitete ekonomike kanë patur më shumë vende të reja pune të krijuara.

Për të parë se në cilat Qarqe ka konsistuar hapja e vendeve të reja të punës shikojmë grafikun në vijim.




Fig.26 Vendet e reja të punës sipas Qarqeve




Fig.27 Vendet e reja të punës sipas Kategorive Profesionale




Fig.28 Vendet e lira të regjistruara në ZP sipas Aktivitete ekonomike

Krahasuar me '2016, kemi rritje të ofertave për Zejtarët, Zanatcinjtë dhe profesionet e lidhura me to, dhe një rënie të ofertave për teknikë dhe specialistë të mesëm dhe për Punonjës të shitjeve dhe shërbimeve.




Fig.29 Vendet e lira te punës krahasuar me Numrin e PU.PA sipas Qarqeve




Fig.30 Vendet e lira te punës krahasuar me numrin e PU.PA sipas Kategorive profesionale

Mospërputhja e ofertës dhe kërkesës për pune është e gjithanshme. Numri i ofertave për punë është **47.9%** e Numrit të punëkërkuesve të papunë të regjistruar në të gjitha ZP, por nëse në qarqet Tiranë dhe Durrës kjo shifër shkon në **80%**, në Qarqet Kukës dhe Dibër varion nga (**9-13**)% të Totalit të PU.PA të regjistruar.

Nëse në kategoritë profesionale të zanatçinjve, teknikëve të mesëm dhe specialistëve me Arsim të lartë, oferta mbulon (**40-100**)% të kërkesave për punësim të PU.PA, për profesionet elementare kemi vetëm **7,314** VLP të regjistruara, ose **21.4%** të Totalit të kërkesave për punësim të PU.PA, nga kjo kategori. Ndërsa nuk ka oferta për PU.PA pa profesion që përbëjnë **8.6%** të Totalit të të papunëve.

## II.3 LEJET E PUNES DHE VËRTETIMET E PUNËSIMIT PËR TË HUAJT

Në zbatim të detyrimeve ligjore [6] një nga aktivitet që ShKP kryen nëpërmjet rrjetit të tij të ZP, është pajisja e shtetasve të huaj me Leje pune.

Shtetasit e huaj që dëshirojnë të punojnë në Shqipëri para fillimit të punës pajisen me një leje pune, ku të përjashtuar nga ky detyrim janë vetëm shtetasit e Bashkimit Europian, shtetasit e zonës Shengen, shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës si dhe shtetasit e Republikës së Kosovës dhe ata të Republikës së Serbisë me përkatësi etnike shqiptare, të cilët para fillimit të punës pajisen me një Vërtetim deklarimi për punësim.

Nga sa më lart për ‘2017, kemi **3,122** shtetas të huaj (ose **201** më pak se një vit më parë) të punësuar. Pjesa më e madhe e lejeve (rreth **41%**) janë në rajonin e Tiranës **32%** jepen nga

[6] Ligjit 108/2013 datë 28/03/2013."Për të Huajt"(i ndryshuar) dhe Vendimeve të Këshillit të Ministrave me Nr. 66-70 dhe 74-85 datë 12.02.2014, si dhe Urdhërit të Ministrit Nr.147, datë 09.07.2014, "Për deklarimin për punësim të shtetasve të Bashkimit Europian, zonës Shengen, Shtetasve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Shtetasve të Republikës së Kosovës dhe Shtetasve të Republikës së Serbise të përkatësisë etnike Shqiptare",

Drejtoria e Përgjithshme e SHKP, por ka dhe në rajonet Durrës (10% e Totalit), Vlorë dhe Fier (4%), etj.




Fig.31 Numri i të huajve të punësuar në Shqipëri sipas Qarqeve




Fig.32 Numri i të huajve të punësuar në Shqipëri sipas Statusit në punësim

Nga **3,122** shtetasit e huaj të punësuar për ‘2017, rezulton se **1,705** janë pajisur me Leje pune dhe **1,417** tjerë me Vërtetime deklarimi për punësim.

Tab.16 Lejet e punës për te huajt sipas Qarqeve dhe Tipit të lejes

| QARQET | LEJE PUNE Gjithsej | Punëmarrës Gjithsej | A/AF | A/KL | A/NK | A/P | A/PSH | A/S | A/SP | A/TN | C | d | investitor( B/I ) | të vetëpunësuar (B/VP ) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **BERAT** | 19 | 19 | 0 | 0 | 0 | 18 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| **DIBER** | 13 | 13 | 0 | 0 | 0 | 13 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

| | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| DURRES | 133 | 102 | 3 | 0 | 0 | 73 | 0 | 0 | 0 | 9 | 15 | 2 | 1 | 30 |
| ELBASAN | 29 | 18 | 0 | 0 | 0 | 17 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 0 | 0 | 11 |
| FIER | 102 | 98 | 0 | 0 | 0 | 88 | 0 | 0 | 0 | 0 | 10 | 0 | 0 | 4 |
| GJIROKASTER | 5 | 3 | 0 | 0 | 0 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 |
| KORÇE | 67 | 64 | 0 | 0 | 0 | 4 | 0 | 0 | 0 | 5 | 0 | 55 | 0 | 3 |
| KUKES | 2 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 |
| LEZHE | 9 | 9 | 0 | 0 | 0 | 7 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| SHK0DER | 27 | 22 | 0 | 0 | 7 | 14 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 5 |
| TIRANE | 651 | 413 | 0 | 1 | 0 | 362 | 1 | 2 | 2 | 13 | 28 | 2 | 0 | 238 |
| VLORE | 35 | 28 | 0 | 0 | 0 | 11 | 0 | 0 | 0 | 9 | 0 | 8 | 0 | 7 |
| Dr.Përgjithshme SH.K.P | 613 | 586 | 0 | 11 | 0 | 456 | 1 | 0 | 0 | 0 | 27 | 76 | 0 | 27 |
| TOTALI | 1705 | 1377 | 3 | 12 | 7 | 1066 | 2 | 2 | 2 | 40 | 80 | 145 | 3 | 325 |

Për të parë aktivitetet ekonomike që "importojnë" punonjës të huaj më shumë (shih graf. në vijim).




Fig.33 Shpërndarja e Lejeve të punës për të huajt, sipas Aktiviteteve ekonomike




Fig.34 Numri i punonjësve të huaj sipas Shtetësisë

Tab.17 Vërtetimet e punësimit sipas shtetësisë. Lejet e punës sipas shtetësisë

| Lloji i shtetësisë | Gjithsej | Femra | Sipas statusit të punësimit: Punëmarrës | investitorë | te vetëpunësuar | Lloji i shtetësisë | Gjithsej | Femra | Sipas statusit të punësimit: Punëmarrës | Investitorë | Te vetëpunësuar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Amerikane** | 80 | 40 | 74 | 1 | 5 | **Boshnjake** | 21 | 1 | 20 | 0 | 1 |
| **Angleze** | 54 | 5 | 48 | 1 | 5 | **Braziliane** | 12 | 2 | 12 | 0 | 0 |
| **Austriake** | 8 | 0 | 6 | 0 | 2 | **Egjiptiane** | 59 | 1 | 49 | 0 | 10 |
| **Belge** | 4 | 0 | 4 | 0 | 0 | **Filipineze** | 51 | 28 | 50 | 0 | 1 |
| **Bullgare** | 21 | 8 | 15 | 0 | 6 | **Indiane** | 60 | 2 | 58 | 0 | 2 |
| **Çeke** | 2 | 1 | 1 | 0 | 1 | **Iraniane** | 13 | 4 | 9 | 0 | 4 |
| **Daneze** | 1 | 0 | 1 | 0 | 0 | **Izraelite** | 20 | 5 | 12 | 0 | 8 |
| **Frqanceze** | 45 | 5 | 38 | 2 | 5 | **Jordaneze** | 13 | 2 | 5 | 0 | 8 |
| **Gjermane** | 41 | 12 | 32 | 1 | 8 | **Kanadeze** | 56 | 6 | 55 | 0 | 1 |
| **Greke** | 123 | 9 | 105 | 2 | 16 | **Kineze** | 208 | 35 | 188 | 0 | 20 |
| **Hollandeze** | 24 | 5 | 23 | 0 | 1 | **Libaneze** | 14 | 0 | 4 | 0 | 10 |
| **Irlandeze** | 22 | 1 | 21 | 0 | 1 | **Malazeze** | 23 | 5 | 19 | 0 | 4 |
| **Italiane** | 646 | 119 | 451 | 11 | 184 | **Maqedonase** | 68 | 10 | 48 | 0 | 20 |
| **Kosovare** | 211 | 33 | 170 | 3 | 38 | **Serbe** | 22 | 13 | 19 | 0 | 3 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Portugeze | 28 | 0 | 27 | 0 | 1 | Turke | 582 | 48 | 496 | 2 | 84 |
| Rumune | 41 | 13 | 41 | 0 | 0 | Ukrahinase | 20 | 11 | 11 | 0 | 9 |
| te tjere | 66 | 10 | 55 | 2 | 9 | Te tjere | 463 | 72 | 322 | 1 | 140 |
| TOTAL | 1417 | 261 | 1112 | 23 | 282 | TOTAL | 1705 | 245 | 1377 | 3 | 325 |

**KAPITULLI III**

# TE DHËNA PER SHËRBIMET DHE PROGRAMET

Një pjesë shumë e rëndësishme e Informacionit të Tregut të Punës, janë të dhënat e siguruara nga monitorimi i politikave të punësimit që ShKP zbaton.

## TREGUESIT E MONITORUESHËM PËR ‘2017

- ✓ Nëpërmjet rritjes së cilësisë së përputhjes së ofertës dhe kërkesës për punës, në bazë të ofertave të grumbulluara nga ana e ZP në shkallë vendi, të realizohen **25.000** punësime të punëkerkuesve ë regjistruar prej te cilave **19.500** të ndërmjetësuar për punë.
- ✓ Numri i vendeve të lira të punës të regjistruara përmes ZP, të rritet me **5%** krahasuar me vitin paraardhës, si dhe niveli i plotësimit te tyre përmes shërbimeve të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, do të rritet me **10%.**
- ✓ Të përfshihen në Programet e nxitjes së punësimit **5,000-5,500** punëkërkues të papunë, nga të cilët **50%** nga Grupet e veçanta (nga skemat e mbështetjes me të ardhura, afatgjatë, mbi 45 vjeç etj.).
- ✓ Të dërgohen në Programin e formimit profesional **17,500** persona nga të cilët **12,500** do të jenë punëkërkues të papunë të orientuar dhe të dërguar nga ZP në kurse profesionesh, dhe **2,000** të çertifikuar të punësohen pas përfundimit të një kursi trajnimi.

Tab.18 Treguesit kryesorë të monitorimit dhe realizimi i tyre sipas Qarqeve

| RAJONET | PU.PA të punësuar | | | Nga Pagesa e papunësisë | | | Nga Ndihma ekonomike | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Plani vjetor | Realizimi | Ne % | Plani vjetor | Realizimi | Në % | Plani vjetor | Realizimi | Në % |
| BERAT | 1285 | 1311 | 102% | 35 | 30 | 86% | 190 | 108 | 57% |
| DIBER | 640 | 459 | 72% | 30 | 5 | 17% | 180 | 82 | 46% |
| DURRES | 4100 | 4335 | 106% | 60 | 25 | 42% | 150 | 100 | 67% |
| ELBASAN | 1700 | 1221 | 72% | 180 | 65 | 36% | 200 | 172 | 86% |
| FIER | 3140 | 3094 | 99% | 100 | 34 | 34% | 350 | 201 | 57% |
| GJIROKASTER | 940 | 512 | 54% | 20 | 13 | 65% | 100 | 48 | 48% |
| KORÇE | 1560 | 1122 | 72% | 110 | 101 | 92% | 300 | 215 | 72% |
| KUKES | 830 | 729 | 88% | 60 | 41 | 68% | 200 | 380 | 190% |
| LEZHE | 1300 | 784 | 60% | 55 | 17 | 31% | 200 | 136 | 68% |
| SHKODER | 1680 | 1716 | 102% | 90 | 66 | 73% | 350 | 254 | 73% |
| TIRANE | 5150 | 5132 | 100% | 200 | 169 | 85% | 550 | 319 | 58% |
| VLORE | 2675 | 2721 | 102% | 60 | 51 | 85% | 230 | 89 | 39% |
| GJITHSEJ | 25000 | 23136 | 93% | 1000 | 617 | 62% | 3000 | 2104 | 70% |

Zbatimi i aktiviteteve në fushën e Shërbimeve të ndërmjetësimit, synojnë direkt përputhjen e ofertës dhe kërkesës për punë. Nga **37,261** vende të lira të ofruara nga subjektet, **72%** janë plotësuar shifër kjo **8%** më e ulët se një vit më parë. Kemi **23,136** punëkërkues të papunë të punësuar nga **25,170** që kishim një vit më parë.

Në vitin 2017 kemi një rënie të përfituesve nga skemat e mbështetjes me të ardhura me **10%** krahasuar me një vit më parë, por përsëri punësimi apo ripunësimi nga ky grup për të gjitha ZP, vijon të jetë i vështirë. Nëse në '2016, u ndërmjetësuan për punë **3,477** punëkërkues të papunë nga skemat e mbështetjes me të ardhura, në '2017 shifra ka shkuar **në 2,486** nga **4.000** që është objektivi vjetor.

Tab.19 Niveli i plotësimit të ofertave sipas Qarqeve

| RAJONET | Vende të lira të shpallura | | | Niveli i plotësimit | PU.PA të punësuar | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | Prej tyre të reja | Prej tyre nga vizitat | | Gjithsej | Pas programit të nxitjes së punësimit |
| **Berat** | 1614 | 1442 | 1043 | **89%** | 1311 | 163 |
| **Dibër** | 601 | 469 | 385 | **74%** | 459 | 161 |
| **Durrës** | 5985 | 4197 | 3190 | **78%** | 4335 | 527 |
| **Elbasan** | 2825 | 762 | 2796 | **26%** | 1221 | 334 |
| **Fier** | 3115 | 2142 | 2357 | **90%** | 3094 | 587 |
| **Gjirokastër** | 562 | 420 | 517 | **91%** | 512 | 130 |
| **Korçe** | 1290 | 1010 | 1268 | **59%** | 1122 | 129 |
| **Kukës** | 585 | 458 | 493 | **86%** | 729 | 122 |
| **Lezhe** | 1149 | 758 | 926 | **71%** | 784 | 235 |
| **Shkodër** | 2690 | 655 | 2445 | **86%** | 1716 | 187 |
| **Tirane** | 13999 | 7970 | 12888 | **63%** | 5132 | 903 |
| **Vlore** | 2846 | 2523 | 1991 | **99%** | 2721 | 173 |
| **Total** | **37261** | **22806** | **30299** | **72%** | **23136** | **3651** |

## III.1 PUNËKËRKUESIT E PAPUNË TË PUNËSUAR

Shërbimet e ndërmjetësimit për punë të realizuara nëpërmjet ZP, kanë mundësuar punësimin e **23,136** punëkërkuesve të papunë nga **25,170** që kishim një vit më parë. Prej këtyre punësimeve **14,662** janë realizuar me ndërmjetësim, direkt nga ZP, **3,651** me programet e nxitjes së punësimit, ndërsa **4,823** punëkërkues të papunë që e kanë gjetur vetë punën.




Fig.35 Pu.Pa. të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) 2016/2017 sipas Qarqeve




Fig.36 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) / PU.PA te regjistruar sipas Qarqeve

## A. GJINIA

Në fund të '2017, rezulton se nga **44,220** punëkërkuese të papuna Femra të regjistruar gjithsej, kanë arritur të punësohen **12,196** prej tyre ose **200** më pak se një vit më parë.

Ndërsa nga **33,415** PU.PA kryefamiljarë, kanë arritur të punësohen vetëm **5,488** prej tyre ose **385** më shumë se një vit më parë.




Fig.37 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) sipas Gjinisë dhe statusit familjar

Punësimi i Femrave varet shumë nga spektri i aktivitetit ekonomik në Qarqe. Në qarkun e Dibrës dhe Kukësit, ku është me i zhvilluar industria nxjerrëse dhe ndërtimi, kjo shifër është (**24-41**)% e Totalit. Ndërsa në qarqet ku ka një zhvillim të madh industria përpunuese sidomos e konfeksioneve kjo shifër shkon deri në(**57-70**)% e Totalit (Qarku i Durrësit, Gjirokastrës dhe Tiranës).




Fig.38 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) sipas Gjinisë dhe Qarqeve

## B. GRUPMOSHA

Po ti referohemi moshës, vihet re që **43%** e Totalit të PU.PA të punësuar janë të rinj deri në 29 vjeç. Ndërsa shanset më të vogla në punësim duket që i kanë grupmoshat e mëdha mbi 50 vjeç, të cilat zënë vetëm **12%** tëTotalit tëtëpunësuarve.




Fig.39 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) sipas Grupmoshave




Fig.40 Pu.Pa., të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) /PU.PA të regjistruar sipas Grupmoshave

Bizneset ku punësohen më shumë të rinjtë janë: Call center, Industria përpunuese dhe Shërbime. Kjo vihet re edhe nga tabela në vijim, ku Qarqet Vlorë, Tiranë Durrës, janë të zhvilluara këto degë, kanë nivelin me të lartë të punësueshmërisë për këtë grupmoshë.

Ndërsa moshat mbi 45 vjeç, punësohen kryesisht në profesione elementare, Femrat në degët e industrisë përpunuese ndërsa Meshkujt në ndërtim dhe miniera.

Tab.20 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) sipas Grupmoshave dhe Qarqeve

| QARQET | 15 - 19 vjeç | 20 - 24 vjeç | 25 - 29 vjeç | 30 - 34 vjeç | 35 - 39 vjeç | 40-49 vjeç | mbi 50 vjeç |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 74 | 274 | 203 | 192 | 150 | 242 | 176 |
| DIBER | 22 | 126 | 110 | 64 | 34 | 75 | 28 |
| DURRES | 456 | 1066 | 766 | 482 | 406 | 708 | 451 |
| ELBASAN | 16 | 203 | 249 | 177 | 146 | 267 | 163 |
| FIER | 107 | 555 | 548 | 411 | 333 | 555 | 585 |
| GJIROKASTER | 10 | 100 | 95 | 92 | 73 | 93 | 49 |
| KORCE | 13 | 169 | 151 | 170 | 124 | 243 | 252 |
| KUKES | 4 | 89 | 128 | 132 | 129 | 191 | 56 |
| LEZHE | 29 | 150 | 110 | 104 | 95 | 192 | 104 |
| SHKODER | 132 | 385 | 284 | 198 | 176 | 326 | 215 |
| TIRANE | 476 | 776 | 876 | 797 | 735 | 1029 | 443 |
| VLORE | 207 | 478 | 437 | 373 | 348 | 609 | 269 |
| **TOTALI** | **1546** | **4371** | **3957** | **3192** | **2749** | **4530** | **2791** |

## C. NIVELI ARSIMOR

Niveli arsimor i ulët i PU.PA të regjistruar pranë Zyrave tona të Punësimit është një pengesë serioze në punësimin e tyre. Punëkërkuesit e papunë me arsim deri në 9 vjeçar, përbëjnë **57%** të Totalit të PU.PA të regjistruar, ndërkohë që **28%** e ofertave të punës janë për specialist me arsim të lartë, teknik të mesëm dhe nëpunës, ndërsa **40%** janë për zanatcinjtë.




Fig.41 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) sipas Nivelit arsimor




Fig.42 PU.PA. të punësuar/PU.PA.të regjistruar sipas Nivelit arsimor

Nga punëkërkuesit e papunë me arsim universitar të punësuar, **31%** janë punësuar në fushën e mësimdhënies, **19%** në shëndetësi, **22%** në administrim biznes, **13%** në fushën e komunikimit dhe informacionit etj.

Tab.21 PU.PA të punësuar sipas Qarqeve dhe Nivelit arsimor

| QARQET | Deri në 9 vjeçar | E mesme e përgjithshme | E mesme profesionale | Universitet |
|---|---|---|---|---|
| BERAT | 675 | 418 | 102 | 116 |
| DIBER | 165 | 157 | 19 | 118 |
| DURRES | 2083 | 1624 | 153 | 475 |
| ELBASAN | 481 | 365 | 106 | 269 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| FIER | 1188 | 1243 | 264 | 399 |
| GJIROKASTER | 171 | 224 | 17 | 100 |
| KORCE | 466 | 359 | 111 | 186 |
| KUKES | 129 | 268 | 91 | 241 |
| LEZHE | 379 | 273 | 33 | 99 |
| SHKODER | 661 | 553 | 155 | 347 |
| TIRANE | 1897 | 1480 | 799 | 956 |
| VLORE | 1400 | 729 | 248 | 344 |
| **TOTALI** | **9695** | **7693** | **2098** | **3650** |




Fig.43 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim+ nxitje+ gjeti punë vetë) 2016/2017 sipas Nivelit arsimor

## D. GRUPET E VEÇANTA

PU.PA., që iu përkasin grupeve të veçanta, kanë prioritet në përfshirjen në të gjitha politikat aktive shtetërore që zbaton ShKP.

Punësimi i tyre vazhdon të mbetet një sfidë për shërbimet publike të punësimit në Shqipëri, (shih grafikun në vijim).




Fig.44PU.PA të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) /PU.PA të regjistruar sipas Grupeve të veçanta

Tab.22 PU.PA të punësuar (Ndërmjetësim+gjeti punë vetë) sipas Gjinisë dhe Grupeve të veçanta

| EMËRTIMI | PU.PA të punësuar Gjithsej | Pagesë papunësie | Ndihmë ekonomike | Afatgjate | Romë/Egjiptianë | Aftesi e kufizuar | Emigrantë të kthyer |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjithsej | 19,485 | 587 | 1899 | 2782 | 676 | 18 | 76 |
| % ndaj Totalit | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 | 100 |
| Femra | 0.51 | 0.49 | 0.49 | 0.42 | 0.56 | 0.56 | 0.37 |
| Meshkuj | 0.49 | 0.51 | 0.51 | 0.58 | 0.44 | 0.44 | 0.63 |

PU.PA të punësuar përfitues nga skemat e mbështetjes me të ardhura, (pagesë papunësie dhe ndihmë ekonomike), përbëjnë vetëm **12%** të Totalit.

Nëse përfituesit e pagesës se papunësisë janë kryesisht të moshave mbi 30 vjeç dhe me arsim jo më pak se të Mesëm, përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike janë kryesisht me arsim deri ne 9 vjeçar dhe të mesëm, dhe i përkasin të gjitha grupmoshave.

Shpesh PU.PA në ndihmë ekonomike janë edhe afatgjatë, ndaj këto grupe kanë të njëjtat karakteristika. Emigrantët e kthyer që janë punësuar janë të moshave (30-45) vjeç dhe kryesisht me arsim të mesëm.

Tab.23 Pu.PA të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) sipas Grupeve të veçanta dhe Qarqeve

| QARQET | PU.PA të punësuar gjithsej | pagesë papunësie | ndihmë ekonomike | afatgjatë | Rome/ Egjiptianë | Aftësi e kufizuar | Emigrante te kthyer |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 1311 | 30 | 108 | 128 | 147 | 1 | 0 |
| DIBER | 459 | 5 | 82 | 99 | 0 | 4 | 0 |
| DURRES | 4335 | 25 | 100 | 359 | 180 | 6 | 6 |
| ELBASAN | 1221 | 65 | 172 | 800 | 92 | 12 | 0 |
| FIER | 3094 | 34 | 201 | 1356 | 19 | 5 | 3 |
| GJIROKASTER | 512 | 13 | 48 | 78 | 1 | 1 | 0 |
| KORCE | 1122 | 101 | 215 | 117 | 88 | 0 | 0 |
| KUKES | 729 | 41 | 380 | 124 | 0 | 0 | 0 |
| LEZHE | 784 | 17 | 136 | 246 | 25 | 3 | 0 |
| SHKODER | 1716 | 66 | 254 | 301 | 54 | 17 | 9 |
| TIRANE | 5132 | 169 | 319 | 855 | 240 | 18 | 64 |
| VLORE | 2721 | 51 | 89 | 28 | 7 | 7 | 0 |
| TOTALI | 23136 | 617 | 2104 | 4491 | 853 | 74 | 82 |




Fig.45 PU.PA të punësuar (ndërmjetësim + nxitje + gjeti punë vetë) nga Grupet e veçanta 2016/2017

## III.2 TË DHËNA PËR PJESMARRËSIT NË PROGRAMET E NXITJES SË PUNËSIMIT

Programet aktive të Tregut të Punës përdoren në të gjithë botën si një nga instrumentet kryesore për trajtimin e problemit të papunësisë. Ashtu si shumica e vendeve europiane, që nga '1999, Shqipëria zbaton një sërë politikash aktive për të "korrigjuar" defektet e Tregut të punës që reflektohen në papunësi.

Nëpërmjet Programeve aktive të Tregut të punës, punëdhënësit subvencionohen për të punësuar dhe trajnuar punëkërkuesit e papunë, duke krijuar vende të reja të qëndrueshme pune ku punësohen kandidatë të ofruar nga zyrat e punësimit. Mbështetja (subvencionimi) nga shteti jepet sipas përcaktimeve të bëra në Programet e nxitjes se punësimit të miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. VKM e nxitjes së punësimit janë subjekt i ndryshimeve të vazhdueshme sipas prioritete të Qeverisë për rritjen e nivelit të punësimit.

Aktualisht, janë në zbatim 7 Programe aktive të nxitjes së Punësimit, të cilat janë hartuar në kuadër të zbatimit të Strategjisë Sektoriale të Punësimit 2014 - 2020 dhe rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Për '2017, VKM pë Programet për Nxitjen e Punësimit **(PNP)** e aplikuar nga SHKP janë:

1 **VKM nr. 27**, datë 11.01.2012 "Për Programin e Nxitjes së Punësimit të femrave nga grupet e veçanta", i ndryshuar
2 **VKM nr. 47**, datë 16.01.2008 "Për Programin e Nxitjes së Punësimit nëpërmjet formimit në punë", i ndryshuar
3 **VKM nr. 48**, datë 16.01.2008 "Për Programin e Nxitjes së Punësimit të punëkërkuesve të papunë në vështirësi", i ndryshuar
4 **VKM nr. 64**, datë 27.01.2016 "Për programin e nxitjes së punësimit të të rinjve që kanë fituar statusin e jetimit"
5 **VKM nr.162**, datë 21.03.2018 "Për pagesën e pjesëmarrjes në kurset e formimit profesional",
6 **VKM nr. 199**, datë 11.01.2012 "Për Masën e Financimit, Kriteret dhe Procedurat e Zbatimit të Programit të Nxitjes së Punësimit të punëkërkuesve të papunë të rinj", i ndryshuar
7 **VKM nr 248**, datë 30.04.2014 "Per programin e nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuara", i ndryshuar
8 **VKM nr. 873**, datë 27.12.2006 "Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për punëkërkuesit e papunë, që kanë mbaruar arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit", i ndryshuar. Aplikimet për këtë program do të jenë deri në fund të vitit buxhetor.

Në zbatim të Programit të Qeverisë për aplikimin e Programeve aktive në tregun e punës, fondi i programeve të nxitjes së punësimit në tre vitet e fundit është shumëfishuar.

Nëse në vitin 2013 ky fond ishte vetëm **90 milion**, për '2017 nga Buxheti i Shtetit për këtë program u akordua një fond prej **490 milion** lekë, duke synuar të përfshihen **5,000 - 5,500** punëkërkues të papunë.




Fig.46 Dinamika e rritjes së Fondit të Nxitjes së punësimit sipas Viteve

Tab.24 Të dhëna për programet e nxitjes së punësimit të zbatuara gjatë '2017.

| VKM | Nr i subjekteve | Numri i punekerkuesve te papune | Fondi i konfirmuar sipas kontratave |
|---|---|---|---|
| VKM 27 | 10 | 10 | 984,200 |
| VKM 47 | 121 | 2224 | 283,966,187 |
| VKM 48 | 332 | 2307 | 166,247,597 |
| VKM 64 | 2 | 2 | 403,592 |
| VKM 199 | 33 | 44 | 4,826,400 |
| VKM 248 | 55 | 79 | 11,021,117 |
| VKM 873 | 115 | 598 | 18,555,622 |
| Shpenzime operative | | | 1,308,659 |
| **SHUMA** | **668** | **5264** | **487,313,374** |

Fondi i për zbatimin e Programeve të nxitjes së punësimit për '2017 është fondi më i lartë i akorduar ndonjëherë që nga fillimi i zbatimit të tyre.

Krahasuar me '2013, kemi gati një **7-fishim** të përfituesve nga këto programe si subjekte (nga **91** në **668**) edhe gjashtëfishim të përfituesve si punëkërkues të papunë (nga **960** në **5,264**).

Tab.25 Subjektet dhe PU.PA- të përfitues nga Programet e nxitjes se punësimit sipas Qarqeve

| RAJONET | Subjekte përfituese | PU.PA përfitues |
|---|---|---|
| Berat | 25 | 196 |
| Diber | 49 | 222 |
| Durrës | 36 | 691 |
| Elbasan | 52 | 456 |
| Fier | 67 | 717 |
| Gjirokastër | 69 | 206 |
| Korçë | 35 | 252 |
| Kukës | 24 | 159 |
| Lezhe | 79 | 422 |
| Shkodër | 70 | 352 |
| Tiranë | 99 | 1370 |
| Vlorë | 63 | 221 |
| **TOTALI** | **668** | **5264** |

## A. SUBJEKTET PËRFITUESE

Nga zbatimi i Programeve të '2017, kanë përfituar gjithsej **668** subjekte**,** nga të cilët **227** janë aplikimet e vitit të kaluar (që vazhdon financimi edhe për këtë vit) dhe **441** janë projekte të reja të këtij viti. Nga totali i subjekteve përfituese 35 subjekte që po zbatojnë Programe të kombinuara. **332** subjekte ose **50%** e Totalit të subjekteve përfituese po zbatojnë programin e subvencionimit në punë (VKM 48) ku janë përfshirë **2307** punëkërkues të papunë nga grupet në vështirësi. Kjo është VKM me spektrin më të madh të shtrirjes për sa i përket aktiviteteve ekonomike të subjekteve përfituese.




Fig.47 Subjektet përfituese sipas Aktiviteteve ekonomike.

Ndërsa 121 subjekte, ose 18% e Totalit të subjekteve përfituese, po zbatojnë Programin e punësimit nëpërmjet trajnimit në vendin e punës (VKM 47), ku janë duke u trajnuar **2,224** Punëkërkues të Papunë në profesionet e fushave të industrisë përpunuese (përpunim produktesh ushqimore, tekstil veshje, lëkurë këpucë, përpunim druri dhe letre) si dhe fushës së ndërtimit.




Fig.48 Subjektet përfituese sipas VKM dhe Aktiviteteve ekonomike

## B. PU.PA - PËRFITUES

Nga zbatimi i Programeve të nxitjes së punësimit për ‘2017**,** janë punësuar, trajnuar nëpërmjet punës dhe kanë kryer praktikat profesionale **5,264** Punëkërkues të Papunë pjesëmarrës në programe**.** Përqindja e pjesëmarrësve në këto programe krahasuar me numrin e punëkërkuesve të papunë të rregjistruar, ishte një nga indikatorët e mbështetjes buxhetore të parashikuar për ‘2017.

Nga **5,310** përfitues që ishin parashikuar të përfitonin nga Programet e Nxitjes së Punësimit, kanë përfituar **5,264** Pu.Pa ose **99%** e parashikimit.




Fig.49 PU.PA përfitues sipas VKM

Nëse i shikojmë përfituesit sipas karakteristikave individuale të tyre, apo kategorive të veçanta ku bëjnë pjesë, kemi **62%** e pjesmarrësve janë Femra kryesisht në Programet e zbatuara sipas VKM 47, 48 dhe 27, si dhe **18%** janë kryefamiljare kryesisht nga familjet në mbështetje me të ardhura të përfshirë më shumë në programin 48 të subvencionimit të punësimit.




Fig.50 PU.PA përfitues sipas Grupmoshës.




Fig.51 PU.PA përfitues sipas Nivelit arsimor.

PU.PA, pjesëmarrës në PNP të moshës deri në 29 vjeç, përbëjnë **56%** të Totalit, ku **598** prej tyre janë studentë të sapodiplomuar të cilët kanë ndjekur praktikat profesionale në **115**

subjekte ku pjesa më e madhe janë institucione të administratës publike, të arsimit, të shëndetësisë, banka etj.

Tab.26 Të dhëna për Programet e nxitjes se punësimit sipas Qarqeve.

| RAJONET | Gjithsej | | VKM 47 | | VKM 48 | | VKM 27 | | VKM 199 | | VKM 248 | | VKM 873 | | VKM 64 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | projekte | PU.PA | projekte | PU.PA | projekte | PU.PA | projekte | PU.PA | projekte | PU.PA | projekte | PU.PA | projekte | PU.PA | projekte | PU.PA |
| BERAT | 25 | 196 | 7 | 115 | 11 | 52 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 7 | 29 | 0 | 0 |
| DIBER | 49 | 222 | 8 | 69 | 16 | 83 | 0 | 0 | 5 | 5 | 3 | 5 | 17 | 60 | 0 | 0 |
| DURRES | 36 | 691 | 15 | 417 | 13 | 236 | 0 | 0 | 1 | 1 | 2 | 2 | 5 | 35 | 0 | 0 |
| ELBASAN | 52 | 456 | 4 | 179 | 31 | 184 | 3 | 3 | 1 | 1 | 6 | 14 | 7 | 75 | 0 | 0 |
| FIER | 67 | 717 | 23 | 359 | 32 | 299 | 0 | 0 | 2 | 3 | 4 | 6 | 6 | 50 | 0 | 0 |
| GJIROKASTER | 69 | 206 | 1 | 10 | 45 | 137 | 0 | 0 | 5 | 5 | 4 | 4 | 14 | 50 | 0 | 0 |
| KORCE | 35 | 252 | 6 | 72 | 20 | 119 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 8 | 60 | 0 | 0 |
| KUKES | 24 | 159 | 4 | 42 | 12 | 67 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 8 | 50 | 0 | 0 |
| LEZHE | 79 | 422 | 6 | 70 | 48 | 301 | 0 | 0 | 6 | 7 | 4 | 4 | 15 | 40 | 0 | 0 |
| SHKODER | 70 | 352 | 9 | 76 | 35 | 201 | 2 | 2 | 1 | 1 | 8 | 11 | 14 | 60 | 1 | 1 |
| TIRANE | 99 | 1370 | 30 | 725 | 43 | 554 | 0 | 0 | 4 | 13 | 16 | 23 | 5 | 54 | 1 | 1 |
| VLORE | 63 | 221 | 8 | 90 | 26 | 74 | 5 | 5 | 7 | 7 | 8 | 10 | 9 | 35 | 0 | 0 |
| **TOTALI** | **668** | **5264** | **121** | **2224** | **332** | **2307** | **10** | **10** | **33** | **44** | **55** | **79** | **115** | **598** | **2** | **2** |

Numrin më të madh të Programeve të zbatuara për ‘2017, e zë Qarku i Tiranës ku në **99** subjekte janë punësuar **1,370** Punëkërkues të Papunë.

Këtu spektri i aktiviteteve ekonomike është më i gjerë. Përveç subjekteve fasonë, industrisë përpunuese dhe të fushës së ndërtimit, bie në sy pjesëmarrja e subjekteve të aktiviteteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Tab.27 PU.PA përfitues nga Programet e nxitjes së punësimit sipas Grupeve të veçanta

| VKM | TOTAL | Nga skemat e mbështetjes me te ardhura | Afatgjate | Rome/egjiptianë | Aftësi te kufizuar | Emigrantë të kthyer |
|---|---|---|---|---|---|---|
| V.K.M 47 | 2224 | 140 | 1127 | 88 | 3 | 23 |
| V.K.M 48 | 2307 | 223 | 1168 | 106 | 6 | 73 |
| V.K.M 27 | 10 | 3 | 1 | 1 | 0 | 0 |
| V.K.M 199 | 44 | 1 | 23 | 1 | 3 | 0 |
| V.K.M 248 | 79 | 12 | 27 | 4 | 79 | 0 |
| V.K.M 873 | 598 | 16 | 130 | 4 | 3 | 0 |
| V.K.M 64 | 2 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 |
| **TOTAL** | **5264** | **396** | **2477** | **204** | **94** | **96** |

## III.3TË DHËNA PËR PJESMARRËSIT NË PROGRAMIN E FORMIMIT PROFESIONAL

Programi i Formimit Profesional, si pjesë e politikave shtetërore aktive në fushën e punësimit, zbatohet nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit nëpërmjet Drejtorive Rajonale te Formimit Profesional publik dhe private. Ato ofrojnë kurse të ndryshme të formimit profesional (formim, riformim dhe riaftësim profesional), për fitimin e kualifikimeve të nevojshme profesionale për t'iu përshtatur kërkesave të Tregut të punës.

Qendrat e Formimit profesional, (QFP) janë institucione ku ofrohen trajnime afatshkurtër (deri në 2 vjet) në profesione të kërkuara nga tregu i punës.

### A. OFRUESIT PUBLIK TE FORMIMIT PROFESIONAL

Në vendin tonë, zhvillojnë aktivitetin e tyre 10 Drejtori Rajonale të Formimit Profesional Publik në Qarqet; Tiranë (2), Durrës, Shkodër, Vlorë, Fier, Korçë, Elbasan, Gjirokastër si dhe Qendra lëvizëse në të gjithë rrethet e zonës verilindore (Kukës, Dibër, Pukë, Mat, Bulqizë Has Tropojë).

Qendrat Publike të Formimit Profesional, ofrojnë kurse të Nivel Kombëtar dhe kurse në Nivel Qendre. Nëse kurset të Nivelit Kombëtar janë unike për të gjitha qendrat në vend, kurset në Nivel Qendre, janë kurse specifike që ofrohen nga qendrat profesionale në funksion të kërkesave që kanë bizneset lokale etj.




Fig.52 Numri i kursantëve sipas QFP Publike

Për sa i përket kohështrirjes, zakonisht Kurset Kombëtare janë kualifikime afat gjatë, por jo më shumë se 2 vite, ndërsa ato në Nivel Qendre janë afatshkurtër dhe shërbejnë kryesisht për kualifikime të shkurtëra, për procese të ndryshme teknologjike etj. Në përfundim të kurseve, kursantët pajisen më Certifikatë.

Tashmë, për të gjithë punëkërkuesit e papunë, ofrimi i kurseve të formimit në këto qendra është pa pagesë.

## B. STRUKTURA E KURSANTËVE

Nga **17,297** kursantë të regjistruar gjatë '2017, në Qendrat Publike të Formimit Profesional, **10,125** (ose rreth **59%**) prej tyre kanë përftuar kualifikime profesionale pa pagesë.

Struktuara e tyre, për çdo QFP, paraqitet në të dhënat në vijim.

Tab.28 Struktura e kursantëve që përftuan pa pagesë kurse pranë Qendrave Publike të FP

| QFP | Pa pagesë (të regjistruar në ZP) | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Të papunë | Pu-Pa | Romë/ Egjiptianë | Emigrantë te kthyer | Me aftësi të kufizuar | Të burgosur |
| Tirana 1 | 2889 | 1867 | 2 | 10 | 3 | 64 |
| Tirana 4 | 1443 | 1156 | 13 | 1 | 23 | 30 |
| Durrës | 1729 | 1729 | 0 | 0 | 0 | 226 |
| Fier | 840 | 840 | 1 | 0 | 7 | 106 |
| Vlorë | 1184 | 1061 | 19 | 16 | 0 | 140 |
| Gjirokastër | 635 | 544 | 0 | 0 | 1 | 8 |
| Elbasan | 1517 | 808 | 0 | 0 | 1 | 0 |
| Korcë | 553 | 520 | 29 | 0 | 4 | 90 |
| Shkodër | 771 | 582 | 3 | 20 | 8 | 0 |
| Lëvizshme | 357 | 354 | 0 | 0 | 8 | 0 |
| **Republika** | **11918** | **9461** | **67** | **47** | **55** | **664** |

Tab.29 Struktura e kursantëve që përftuan me pagesë kurse pranë Qendrave Publike të FP

| QFP | Me pagesë | | |
|---|---|---|---|
| | Të punësuar | Të Papunë | Të tjerë |
| Tirana 1 | 890 | 1022 | 30 |
| Tirana 4 | 1647 | 287 | 23 |
| Durrës | 200 | 0 | 0 |
| Fier | 148 | 0 | 3 |
| Vlorë | 242 | 123 | 300 |
| Gjirokastër | 80 | 91 | 78 |
| Elbasan | 463 | 709 | 79 |
| Korcë | 255 | 33 | 87 |
| Shkodër | 153 | 189 | 8 |
| Lëvizshme | 29 | 3 | 0 |
| **Republika** | **4107** | **2457** | **608** |




Fig.53 Të trajnuarit në QFP Publike sipas Profesioneve

Edhe pse në ulje, Kurset për mësimin e gjuhëve të huaja, vazhdojnë të dominojnë pjesëmarrjen me **13.3%** të Totalit të kursantëve, kryesisht nga të punësuarit dhe nxënësit e shkollave. Fluks në rritje të kërkesave evidentohet për mësimin e gjuhës gjermane.

Referuar kurseve të profesioneve, më të frekuentuarit, në raport me totalin e pjesmarrësve, kanë qënë Instalues dhe riparues të rrejtit elektrik" (**12%**), Kuzhina (**9%**), Hidraulik (**7%**), Rrobaqepsi (**4%**), Parukeri (**4%**) dhe Berber (**4%**).

Tab.30 Të dhëna për kurset e formimit profesional të përfunduara në QFP Publike

| QFP-te Publike | te regjistruar | femra | te papune | prej tyre PU.PA | te punësuar | të tjerë | Të certifikuar | prej tyre femra | prej tyre punëkërkues të papunë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tirana 1 | 3873 | 1426 | 2889 | 1867 | 890 | 30 | 3403 | 1243 | 1708 |
| Tirana 4 | 3143 | 938 | 1443 | 1156 | 1647 | 23 | 2779 | 838 | 913 |
| Durrës | 2155 | 879 | 1729 | 1729 | 200 | 0 | 2135 | 868 | 1723 |
| Fier | 1097 | 321 | 840 | 840 | 148 | 3 | 926 | 267 | 710 |
| Vlorë | 1866 | 697 | 1184 | 1061 | 242 | 300 | 1797 | 676 | 1027 |
| Gjirokastër | 801 | 424 | 635 | 544 | 80 | 78 | 795 | 421 | 540 |
| Elbasan | 2059 | 699 | 1517 | 808 | 463 | 79 | 1825 | 637 | 723 |
| Korcë | 985 | 305 | 553 | 520 | 255 | 87 | 826 | 247 | 432 |
| Shkodër | 932 | 265 | 771 | 582 | 153 | 8 | 844 | 243 | 519 |
| Lëvizshme | 386 | 246 | 357 | 354 | 29 | 0 | 381 | 242 | 350 |
| TOTALI | 17297 | 6200 | 11918 | 9461 | 4107 | 608 | 15711 | 5682 | 8645 |

Përveç të papunëve në Qendrat Publike te Formimit Profesional, ndjekin kurset edhe të Punësuar (kurse suplementare), Të burgosur (kurse trajnimi gjatë periudhës së kryerjes së dënimit)[7] si dhe nxënës/studentë, pjesa më e madhe e të cilëve ndjekin kurset e gjuhëve të huaja apo përdorim kompjuteri.

Tab.31Të dhëna për PU.PA të trajnuar sipas QFP Publike

| QFP-te Publike | Gjithsej | Nga pagesa | Nga ndihma | Afatgjatë | Romë/ Egjiptianë | Aftësi e kufizuar | emigrantë të kthyer | Të tjerë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tirana 1 | 1867 | 0 | 7 | 0 | 2 | 3 | 10 | 1845 |
| Tirana 4 | 1156 | 0 | 48 | 33 | 13 | 23 | 1 | 1038 |
| Durrës | 1729 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1729 |
| Fier | 840 | 0 | 3 | 102 | 1 | 7 | 0 | 727 |
| Vlorë | 1061 | 58 | 72 | 0 | 19 | 0 | 16 | 896 |
| Gjirokastër | 544 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 543 |
| Elbasan | 808 | 0 | 0 | 807 | 0 | 1 | 0 | 0 |
| Korcë | 520 | 1 | 2 | 34 | 29 | 4 | 0 | 450 |
| Shkodër | 582 | 1 | 32 | 3 | 3 | 8 | 20 | 515 |
| Lëvizshme | 354 | 0 | 0 | 0 | 0 | 8 | 0 | 346 |
| **TOTALI** | **9461** | **60** | **164** | **979** | **67** | **55** | **47** | **8089** |

Pjesmarrës në këtë Program për '2017, janë **17,297** kursantë nga të cilët **15,711** janë certifikuar, ose **203** më pak se treguesi strategjik i planifikuar (treguesi i vendosur për 2017 ishte **17,500**).

[7] Sipas marrëveshjes nr.1366 te korrikut te 2009 midis M.P.Ç.S.SH.B dhe Ministrisë se Drejtësisë,

## Tab.32 Të dhëna për pjesëmarrësit në Kurset e Formimit Profesional sipas profesioneve (Qendrat Publike)

| EMËRTIMI I KURSIT | Te trajnuar gjithsej | prej tyre Femra | Te papune | Prej tyre PU.PA | te punësuar | të burgosur | të tjerë | të çërtifikuar | prej tyre femra | prej tyre PU.PA |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Administrator pallati | 165 | 21 | 127 | 70 | 33 | 0 | 5 | 154 | 13 | 70 |
| Art Design | 336 | 183 | 254 | 241 | 82 | 0 | 0 | 271 | 161 | 191 |
| Asistente, specialist të punës sociale | 486 | 373 | 344 | 311 | 102 | 26 | 14 | 433 | 326 | 287 |
| Banakier | 93 | 22 | 91 | 86 | 2 | 0 | 0 | 89 | 21 | 82 |
| Berber | 686 | 2 | 477 | 420 | 167 | 28 | 14 | 619 | 0 | 379 |
| Lidership | 62 | 38 | 33 | 30 | 24 | 0 | 5 | 59 | 37 | 29 |
| Elektroaut për automjete | 423 | 0 | 280 | 235 | 142 | 0 | 1 | 391 | 0 | 214 |
| Estetist | 512 | 507 | 393 | 361 | 106 | 0 | 13 | 461 | 460 | 325 |
| Hidraulik | 1246 | 1 | 841 | 744 | 312 | 72 | 21 | 1139 | 0 | 697 |
| Instalues dhe riparues rrjeti elektrik | 2018 | 79 | 940 | 691 | 998 | 49 | 31 | 1938 | 70 | 653 |
| Instalues dhe Riparues te sistemeve ngrohëse-ftohëse | 406 | 0 | 329 | 274 | 77 | 0 | 0 | 389 | 0 | 264 |
| Instalues të paneleve diellore | 268 | 0 | 201 | 179 | 51 | 15 | 1 | 238 | 0 | 159 |
| Kamarier | 111 | 22 | 111 | 110 | 0 | 0 | 0 | 105 | 21 | 104 |
| Kopështar | 105 | 32 | 68 | 65 | 9 | 28 | 0 | 101 | 32 | 61 |
| Kujdestar fëmijësh | 282 | 269 | 216 | 195 | 64 | 0 | 2 | 260 | 247 | 178 |
| Kushinier | 1600 | 728 | 1105 | 965 | 418 | 68 | 9 | 1458 | 676 | 865 |
| Bojaxhi/llamarinisje | 131 | 0 | 56 | 51 | 73 | 0 | 2 | 110 | 0 | 38 |
| Mekanik | 273 | 0 | 189 | 178 | 73 | 0 | 11 | 241 | 0 | 163 |
| Menaxhim ndërmarrjesh | 204 | 125 | 150 | 132 | 54 | 0 | 0 | 181 | 113 | 128 |
| Operator turistik | 338 | 146 | 194 | 170 | 70 | 71 | 3 | 326 | 138 | 164 |
| Parukier | 752 | 687 | 689 | 663 | 48 | 14 | 1 | 683 | 656 | 615 |
| Pasticier | 66 | 35 | 46 | 46 | 1 | 9 | 10 | 65 | 35 | 46 |
| Punetor ndërtimi (hekurpunues kartpentier) | 345 | 0 | 242 | 188 | 103 | 0 | 0 | 300 | 0 | 154 |
| Punues druri | 189 | 0 | 135 | 126 | 32 | 21 | 1 | 163 | 0 | 106 |
| Riparim mak. Tekstili | 140 | 2 | 99 | 86 | 41 | 0 | 0 | 132 | 1 | 80 |
| Riparim paisjesh el.shtepiake dhe te tjera | 313 | 0 | 246 | 230 | 57 | 4 | 6 | 280 | 0 | 204 |
| Riparue elektronik per kompjutera | 197 | 13 | 132 | 105 | 48 | 0 | 17 | 157 | 9 | 88 |
| Riparues dhe mirembajtes te automjeteve | 472 | 0 | 304 | 269 | 166 | 0 | 2 | 420 | 0 | 240 |
| Sherbime hotelerie | 205 | 114 | 182 | 155 | 21 | 0 | 2 | 188 | 105 | 147 |
| Rrobaqepsi | 846 | 828 | 761 | 682 | 50 | 30 | 5 | 781 | 776 | 628 |
| Saldator | 523 | 0 | 323 | 267 | 193 | 7 | 0 | 472 | 0 | 253 |
| Sekretari | 280 | 238 | 241 | 230 | 30 | 8 | 1 | 260 | 221 | 217 |
| gjuhe e huaj | 2299 | 1281 | 1601 | 535 | 226 | 175 | 297 | 2019 | 1155 | 490 |
| modelim stilim | 130 | 120 | 91 | 82 | 37 | 0 | 2 | 107 | 98 | 65 |
| perdorim kompjuteri | 343 | 174 | 100 | 17 | 72 | 39 | 132 | 317 | 164 | 17 |
| Të tjera | 452 | 160 | 327 | 272 | 125 | 0 | 0 | 404 | 147 | 244 |
| **TOTALI** | **17297** | **6200** | **11918** | **9461** | **4107** | **664** | **608** | **15711** | **5682** | **8645** |




Fig.54 Të dhëna për PU.PAtë trajnuar sipas profesioneve (Qendrat Publike)

Kanë ndjekur një kurs formimi në Qendrat Publike **9,461** PU.PA (ose **3,039** më pak se treguesi strategjik i planifikuar për ’2017), nga te cilët **8,645** janë certifikuar (treguesi i vendosur ishte **12,500**).




Fig.55 Të dhëna për PU.PA e trajnuar nga Grupet e veçanta




Fig.56 Të trajnuar sipas Grupmoshave dhe Profesioneve




Fig.57 Pjesëmarrësit sipas Nivelit arsimor dhe Profesioneve




Fig.58 Niveli i Punësimit pos Formim sipas Kurseve

Të rinjtë pjesëmarrës në kurset profesionale pranë Qendrave të Formimit Profesional Publik, përbejnë **61%** të Totalit të pjesëmarrësve. Ajo që duhet theksuar që në të gjitha profesionet pjesëmarrja e të rinjve ngelet mbi **50%.**

Pjesëmarrësit me nivel arsimor të mesëm përbejnë **59%** të Totalit të pjesëmarrësve.

Nëse i referohemi llojit të kurseve, shikojmë që përveç kursit Art desing dhe Përdorim kompjuteri, ku një pjesë të konsiderueshme e zënë pjesëmarrësit me Arsim të lartë, në të gjitha kurset e tjera, Arsimi i mesëm përbën mbi **45%** të pjesëmarrësve në çdo kurs.

PU.PA., pjesëmarrës në këtëProgram, që kanë arritur të punësohen në përfundim të formimit profesional janë **861**, tregues ky i pa realizuar (treguesi i vendosur ishte **2,000**).

Nëse pjesëmarrja në kurse për formim profesional është e kënaqshme, punësimi pas certifikimit, vazhdon të mbetet një problem serioz pasi, vetëm **4.9%** e punëkërkuesve të papunë të trajnuar gjatë këtij vitit në kurset e profesioneve, kanë arritur të punësohen.

## III.4. TE DHËNA PËR PJESËMARRËSIT NË PROGRAMIN E PAGESËS SË PAPUNËSISË

Programi i pagesës së papunësisë është pjesë e politikave shtetërore të punësimit, të cilat sigurojnë mbështetjen me të ardhura të papunëve në momentin e daljes së tyre si të tillë, duke synuar krijimin e kushteve për rikthimin e tyre në tregun e punës.

Programet e Pagesës së Papunësisë, synojnë të mbështesin financiarisht të gjithë punëkërkuesit e papunë në rast papunësie për shkak të shkurtimit të vëndit të punës, ndërprejes së kontratës së punës, falimentimit të ndërmarjes, zvogëlimit të aktivitetit etj, duke lehtësuar sadopak përpjekjet e tyre drejt punësimit.

Aktualisht këto shërbime kryhen në zbatim të ligjit të sigurimeve shoqërore dhe është po ashtu respektim i së drejtës së shtetasve rezidente në Shqipëri për “Mbështetje në të ardhura te garantuar nga ligji për nxitjen e punësimit[8].

Pavarësisht se kontributet për sigurimin nga papunësia mblidhen nga sigurimet shoqërore, duke ndjekur shembullin e pjesës më të madhe të vendeve të Europës, pagesa e papunësisë i është deleguar për ekzekutim ZP.

Të drejtënpër të përfituar e kanë të gjithë personat, që janë të siguruar në sigurimet shoqërore dhe për ta është kontribuar sigurim përpapunësi jo me pak se 12 muaj janë të vërtetuar nga ZP se janë të papunë dhe pranojnë te kualifikohen dhe rikualifikohen nuk marrin përfitime të tjera nga ligji i Sigurimeve Shoqërore, me përjashtim të pensionit të pjesshëm te invaliditetit.

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për ketë Program çdo vit merr pjesën e kryesore tek totali i buxhetit te Shërbimit Kombëtar te Punësimit.

[8]Neni 1, parag.2.




Fig.59 Fondi i Pagesës së papunësisë në Vite

Fondi i kursyer nga zbatimi i këtij Programi për vitin 2017, shënon **191 milion** (nga **536 milion** të planifikuara janë shpenzuar vetëm **345 milion**).

Ndryshimet në bazën ligjore të këtij Programi, të miratuara në fillim të '2016, ku kohëzgjatja e përfitimit varej nga periudha e derdhjes së kontributeve në sigurimet shoqërore, bëri që të evitoheshin futjet dhe daljet fiktive nga skema e pagesës së papunësisë të punonjësve nga subjektet, sidomos ato fason.

Në fund të 2017, Programi i pagesës së papunësisë shënoi shifrën më të ulët të përfituesve që nga krijimi i tij si skemë (**1,959** në të gjithë vendin).




Fig.60PU.PA të regjistruar në Pagesë papunësie sipas Muajve




Fig.61 PU.PA të regjistruar në pagesë papunësie sipas Periudhes së përfitimit

Tab.33 Bilanci vjetor i skemës së pagesës së papunësisë.

| Shtesat për muajin | | | | | | | Pakësim për muajin | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjithsej | | | Arsyet e papunësisë | | | | Gjithsej | | | Arsyet e largimit | | | |
| **Gjithsej** | shtet | privat | reformat | prishje /mbarim kontrat punësimi | ristrukturim/privatizim ndërmarrjes | arsye të tjera | gjithsej | shtet | privat | ndërmjetësuar për punë | pjesëm.progr.nxitje.pune s. | mbarojnë afatin e përfitimit | arsye të tjera |
| 5234 | 998 | 4236 | 460 | 3326 | 911 | 537 | 6984 | 1858 | 5126 | 587 | 12 | 6140 | 245 |




Fig.62 Hyrjet sipas sektorëve dhe Qarqeve

Ndërsa daljet vjetore shkojnë në shifrën e 6,984, vetëm 8.6% e Totalit të daljeve janë largime për arsye punësimi nga 15% që ishte një vit më parë.




Fig.63 PU.PA të regjistruar në pagesë papunësie sipas Qarqeve dhe Gjinisë

Tab.34 Pu.Pa të regjistruar në pagesë papunësie sipas Grupmoshës dhe Nivelit arsimor

| QARQET | të rinj | 30-44 vjeç | mbi 45 vjeç | deri ne 9 vje | mesme | universitare |
|---|---|---|---|---|---|---|
| BERAT | 11 | 16 | 52 | 27 | 40 | 12 |
| DIBER | 24 | 31 | 30 | 29 | 33 | 23 |
| DURRES | 13 | 40 | 69 | 48 | 52 | 22 |
| ELBASAN | 23 | 59 | 128 | 43 | 123 | 44 |
| FIER | 14 | 33 | 57 | 34 | 44 | 26 |
| GJIROKASTER | 16 | 31 | 34 | 30 | 32 | 19 |
| KORCE | 19 | 52 | 137 | 40 | 122 | 46 |
| KUKES | 71 | 37 | 51 | 16 | 56 | 87 |
| LEZHE | 13 | 24 | 50 | 35 | 44 | 8 |
| SHKODER | 34 | 57 | 128 | 87 | 93 | 39 |
| TIRANE | 48 | 160 | 291 | 167 | 230 | 102 |
| VLORE | 18 | 54 | 34 | 19 | 59 | 28 |
| TOTAL | 304 | 594 | 1061 | 575 | 928 | 456 |

## KAPITULLI IV

# TE DHENA PER ADMINISTRIMIN E BURIMEVE FINANCIARE DHE NJEREZORE

Performanca e politikave të punësimit në Tregun e punës është e lidhur ngushtësisht me performancën e stafit të sistemit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit si dhe mirëmenaxhimin e buxhetit vjetor të tij.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit të Shqipërisë është themeluar në vitin 1995 si një shërbim publik, autonom, me Statutin e saj dhe administrim qendror, veprimtaria e të cilit bazohet në tre Nivele: Qendror, Rajoni (Qarku) e Vendor.

Në strukturën e SHKP bëjnë pjesë: Drejtoria e Përgjithshme e SHKP (me vendndodhje në Tiranë), një rrjet i përbërë nga 12 Drejtori Rajonale të Punësimit, 24 Zyra Vendore të Punësimit dhe 10 Qendra Rajonale të Formimit Profesional Publik, përfshi edhe atë Lëvizëse për Zonën Verilindore.

Shërbimi Kombëtar i Punësimit administron dhe menaxhon fonde për:

- ✓ Administratën qendrore dhe ato lokale;
- ✓ Programin e Nxitjes së Punësimit;
- ✓ Programin e Formimit Profesional;
- ✓ Programin e Pagesës se Papunësisë;
- ✓ Investime.

Tab.35 Fondi i SHKP-së sipas programeve në Vite

| Aktiviteti | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013 | 2014 | 2015 | 2016 | 2017 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Pagese papunësie | 868.5 | 870.6 | 868.2 | 981.8 | 875.9 | 1000 | 860 | 846 | 800 | 1000 | 536 |
| Nxitje | 119.2 | 212.3 | 181.7 | 133.2 | 129.5 | 90 | 90 | 270.6 | 450 | 490 | 490 |
| Formim profesional | 97.3 | 116.1 | 124.3 | 128.7 | 98 | 109 | 138.5 | 200 | 217 | 206 | 245 |
| Administrata | 270 | 310.9 | 304 | 289.4 | 300.6 | 308 | 305.8 | 370 | 323 | 335 | 330 |
| Investime | 76.3 | 113.4 | 48.7 | 38.6 | 16.9 | 23 | 5.9 | 26.4 | 36 | 127 | 77 |
| **TOTAL** | **1431.3** | **1623.3** | **1526.9** | **1571.7** | **1420.9** | **1530** | **1400.2** | **1713** | **1826** | **2158** | **1678** |



Në Nivel Kombëtar funksionojnë:

- ✓ 12 Drejtori Rajonale
- ✓ 24 Zyra Vendore të Punësimit

Fig.64 Shpërndarja gjeografike e Institucioneve të Punësimit

Tab.36 Realizimi i Treguesve të Buxhetit për vitin 2017

| Nr.Artik | EMERTIMI | Buxheti fillestar 2017 | Buxheti 2017 i rishikuar me ndryshime | Fakti | % |
|---|---|---|---|---|---|
| **Administrata lokale Sh.K.P.** | | **229,402,314** | **256,249,664** | **250,213,885** | **98%** |
| 600 | Paga | 162,450,000 | 181,306,850 | 177,914,000 | 98% |
| 601 | Sigurime Shoqerore | 31,452,314 | 31,008,314 | 29,634,793 | 96% |
| 602 | Mallra e sherbime | 35,500,000 | 43,200,000 | 42,347,599 | 98% |
| 606 | Fond i vecante | | 734,500 | 317,493 | 43% |
| 603 | Nxitje punesimi | 490,000,000 | 490,000,000 | 474,950,984 | 97% |
| 606 | Pagese Papunesie | 800,000,000 | 536,020,550 | 345,081,596 | 64% |
| **Administrata qendrore Sh.K.P.** | | **78,197,686** | **73,893,586** | **72,719,720** | **98%** |
| 600 | Pagat | 25,550,000 | 30,170,000 | 29,724,624 | 99% |
| 601 | Sigurimet Shoqerore | 5,147,686 | 5,063,586 | 4,877,801 | 96% |
| 602 | Mallra e sherbime | 47,500,000 | 38,600,000 | 38,087,295 | 99% |
| 606 | Fond i vecante | | 60,000 | 30,000 | 50% |
| **Formimi Profesional** | | **203,000,000** | **245,189,450** | **229,910,415** | 94% |
| 600 | Pagat | 140,000,000 | 174,337,500 | 163,637,473 | 94% |
| 601 | Sigurimet Shoqërore | 23,000,000 | 29,389,200 | 27,307,043 | 93% |
| 602 | Mallra e shërbime | 40,000,000 | 41,200,000 | 38,703,149 | 94% |
| 606 | Fond i vecantë | | 262,750 | 262750 | 100% |
| Të ardhurat nga Form.Profesional | | **8,000,000** | **8,000,000** | **5,678,644** | **71%** |
| 600 | Paga | 3,000,000 | 3,000,000 | 1,357,170 | 45% |
| 602 | Mallra e sherbime | 5,000,000 | 5,000,000 | 4,321,474 | 86% |
| 231 | Investime nga të ardhurat | 0 | 0 | 0 | |
| | Investime buxhetore | 41,000,000 | 77,900,000 | 76,712,940 | 98% |
| **TOTALI** | | **1,849,600,000** | **1,687,253,250** | **1,455,268,184** | **86%** |

Tab.37 Stafi i SHKP sipas Kategorisë profesionale

| KATEGORITË | Nr. punonjësve | | ZP | | QFP | | Drejtoria qendrore | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Gjithsej | F | Gjithsej | F | Gjithsej | F | Gjithsej | F |
| **Drejtues** | 62 | 30 | 45 | 22 | 12 | 5 | 5 | 3 |
| **Specialistë me arsim të lartë** | 327 | 236 | 222 | 161 | 81 | 54 | 24 | 21 |
| **Teknikë dhe specialistë në zbatim** | 10 | 6 | 1 | 0 | 9 | 6 | 0 | 0 |
| **Nëpunës të thjeshtë** | 7 | 3 | 4 | 1 | 1 | 1 | 2 | 1 |
| **Punëtorë** | 10 | 6 | 1 | 1 | 6 | 4 | 3 | 1 |
| **TOTAL** | 416 | 281 | 273 | 185 | 109 | 70 | 34 | 26 |







Fig.65 Stafi i SHKP-së sipas Gjinisë

Për sa i përket arsimit, **94%** e të gjithë stafit janë me arsim të lartë, me një pagë mujore mbi **40 mijë** Lekë.




Fig.66 Shpërndarja e personelit të ZP sipas Qarqeve